



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 24 regjistër (JR)
Datë 10.05.2021

Nr. 27 i vendimit
Datë 05.07.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 05.07.2023, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Enrik Haxhiraj, prokuror në Prokurorinë e Gjykatës së Apelit Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 339, datë 19.01.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Enrik Haxhiraj.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet A, Ç, D dhe F të Aneksit të Kushtetutës; nenet 63 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 339, datë 19.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Enrik Haxhiraj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Gjykatës së Apelit Vlorë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me nr. {***} prot., datë 10.04.2018, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesa dokumentacioni justifikues ligjor*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *ka kryer fshehje pasurie*; (iv) *ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.
4. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim ka dërguar raportin e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

5. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.
6. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar vetëm në kriterin e pasurisë. Bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit, si dhe pasi shqyrtoi të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin që subjektit të rivlerësimit Enrik Haxhiraj, prokuror në Prokurorinë e Gjykatës së Apelit Vlorë, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 339, datë 19.01.2021, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Vendimi i Komisionit, për shkarkimin e subjektit nga detyra, është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

7.1 Për vlerësimin e kriterit të pasurisë: (i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë e tij, sipas pikës 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.* (ii) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim, referuar paragrafit 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.* (iii) *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.* (iv) *Subjekti ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive, në kuptim të gërmës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.* (v) *Sikurse është arsyetuar më sipër, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësia, pasi ka përdorur funksionin e tij si kryetar gjykate dhe ka arritur të përfitojë strehim, rrethanë të cilën e ka shfrytëzuar menjëherë duke përfituar të ardhura monetare dhe jo për qëllimin për të cilin i ishte dhënë.*

III. Mbi ankimin dhe shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit

8. Më datë 11.01.2021 është depozituar ankimi nga subjekti i rivlerësimit, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., kundër vendimit nr. 339, datë 19.01.2021, të Komisionit. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63¹, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në konkluzion të ankimit të tij, subjekti i rivlerësimit kërkoi që shkaqet e ankimit t'i marrë në shqyrtim Kolegji, duke kërkuar:

8.1 Kalimin për gjykim në seancë publike, të çështjes administrative me nr. 339, datë 19.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit Enrik Haxhiraj.

¹ “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit”.

8.2 Kryerjen e hetimit gjyqësor nga fillimi. Marrjen e provave të kërkuara prej subjektit, si dhe ato të reja.

8.3 Vazhdimin e hetimit edhe për dy komponentët e tjerë të procesit të rivlerësimit që lidhen me vlerësimin e figurës dhe aftësive profesionale.

8.4 Ndryshimin e vendimit nr. 339, datë 19.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Enrik Haxhiraj me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

8.5 Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

8.5.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon se bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Kolegji duhet të vendosë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, pasi debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar objektivisht të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe për vazhdimin e hetimit administrativ edhe për dy komponentët e tjerë të procesit të rivlerësimit.

Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

8.5.2 **Lidhur me analizën financiare të vitit 2006** dhe të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti privat i bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është i paarsyetuar, pasi nuk i është dhënë përgjigje pretendimeve të tij, argumenteve ligjore dhe konkluzioneve të Raportit të Audituesit Ligjor, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 49 të ligjit nr. 86/2016.

- Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit se nuk ka pasur burime të ligjshme për investimin gjatë vitit 2006 për pasurinë shtëpi banimi të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, pasi mungesa e fondeve është vetëm në shumën (-) 81.482 lekë, duke mos pranuar diferencën negative të rezultuar nga analiza e Komisionit prej (-) 345.873 lekësh.

- Subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit për të moskonsideruar gjendjen *cash* të padeklaruar si shtesa e pakësime para vitit 2006 në deklaratat periodike të pasurisë.

8.5.3 **Lidhur me analizën financiare të vitit 2007** dhe të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti privat i bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit kundërshton mënyrën e përlllogaritjes së fitimit nga Komisioni.

- Në lidhje me huan e marrë nga personi i lidhur V. M., subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se huadhënësi nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të dhënë shumën prej 20.000 eurosh.

- Në lidhje me investimin gjatë vitit 2007, për pasurinë “godinë 3-katëshe”, të ndodhur në Lagjen “{***}”, Vlorë, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar, pasi, sipas tij, rezulton me balancë pozitive në shumën 40.281 lekë.

8.5.4 **Lidhur me analizën financiare të vitit 2008**, sa i përket të ardhurave nga aktiviteti privat i bashkëshortes, subjekti kundërshton vlerën e konsideruar si fitim nga Komisioni.

Në analizën financiare për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit, mbështetur në raportin e audituesit ligjor, pretendon se gjendet në kushtet e një balance pozitive në shumën 1.227.321 lekë.

- Në lidhje me investimin gjatë vitit 2008, për shtëpinë e banimit të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht investimin e kryer në shumën 516.800 lekë.

8.5.5 Lidhur me analizën financiare të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit pretendon se duhet të bazohemi në rezultatin e nxjerrë nga audituesi ligjor, sipas së cilit analiza e vitit 2009 rezulton me diferencë pozitive në shumën 200.778 lekë.

- Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton moskonsiderimin nga Komisioni në zërin “të ardhura” të shumës prej 20.000 USD të marrë në formën e huas nga T. M., për të mos u përdorur, por të vendosur si garanci bankare.

- Në lidhje me dy depozitat bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe NBG Bank të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tyre, duke qenë se nuk kanë deklaruar shtesa të likuiditeteve *cash* për periudhën e deklarimit 2003 - 2008.

8.5.6 Lidhur me analizën financiare të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për rezultat financiar negativ për vitin 2010 në shumën (-) 3.935.063 lekë dhe për analizën e fragmentuar deri në datën 02.06.2010 që Komisionit i rezultoi në diferencën negative në shumën (-) 1.759.308 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit, analiza duhej të rezultonte me diferencë pozitive për gjithë vitin 2010 në shumën 964.494 lekë dhe për periudhën e fragmentuar 01.01.2010 - 02.06.2010, me diferencë pozitive në shumën 194.084 lekë.

- Subjekti i rivlerësimit pretendon se nga Komisioni nuk është llogaritur në mënyrë të saktë tarifa e shkollimit të vajzës së tij në Universitetin “{***}”, si dhe Komisioni ka gabuar që nuk e ka përfshirë si të ardhur të ligjshme, shumën prej 10.000 eurosh të marrë hua nga miku i tij A. D.

8.5.7 Lidhur me analizën financiare të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se Komisioni ka gabuar në konkluzionin e tij se ky vit paraqet balancë negative në shumën (-) 706.992 lekë, duke qenë se për këtë vit, sipas analizës së kryer nga audituesi ligjor, diferenca është pozitive në shumën 30.625 lekë.

- Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni e ka ngarkuar dy herë me shpenzime udhëtimi në shumën prej 180.609 lekësh dhe interesa të *overdraft*-it në shumën prej 611.442 lekësh, pranë Intesa Sanpaolo Bank.

8.5.8 Lidhur me analizën financiare të vitit 2013, subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit për diferencën negative të këtij viti në shumën (-) 1.164.816 lekë është i gabuar. Sipas subjektit të rivlerësimit në analizën e Komisionit nuk është paraqitur për vitin 2013 zëri “Detyrime” për parapagimin në shumën 3.927.812 lekë, për pasurinë “njësi”, me sipërfaqe 23,8 m², e ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, në emër të subjektit tregtar “I. B.”.

- Sipas subjektit të rivlerësimit vlera e pasurisë “njësi”, me sipërfaqe 23,8 m², në qytetin e Vlorës, është paraqitur në pasqyrën financiare të vitit 2013 në grupin “Aktive”, kreditë dhe *overdraft*-i janë pasqyruar në grupin “Pasive”.

8.5.9 Lidhur me analizën financiare për vitin 2014 subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën e Komisionit, e cila ka rezultuar me diferencë negative në shumën (-) 731.556 lekë dhe pretendon se analiza e saktë është ajo e kryer nga audituesi ligjor, e cila ka rezultuar me balancë pozitive në shumën 210.627 lekë.

8.5.10 Lidhur me automjetin tip “DaimlerChrysler”, me targë {*}**, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se ai nuk e ka deklaruar këtë pasuri në Deklaratën e Interesave Private Periodike (në vijim “DIPP”) të vitit 2015 dhe në deklaratën *vetting*, është i gabuar. Subjekti i rivlerësimit argumenton se nga verifikimi i kryer me personelin e teknologjisë së informacionit në kompjuterin e punës, ku subjekti i rivlerësimit ka pasur të ruajtur deklaratën e pasurisë për vitin 2015, e cila është dorëzuar në vitin 2016, rezulton të jetë e deklaruar prej tij kontrata e shitblerjes së këtij mjeti në seksionin përkatës së kësaj deklarate.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit Enrik Haxhiraj, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimitimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65², pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 339, datë 19.01.2021, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Enrik Haxhiraj, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

² “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

11.1 Kolegji shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur në ankim për marrjen e provave të reja, si dhe shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

11.2 Kolegji vëren se në ankimin e paraqitur prej subjektit të rivlerësimit janë bashkëngjitur disa akte që shoqërojnë ankimin, si vijon:

- a) vërtetim datë 09.04.2021, lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank;
- b) konfirmë bankare, lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank;
- c) konfirmë bankare, lëshuar nga BKT;
- d) konfirmë bankare, lëshuar nga Fibank, NBG Bank dhe BKT;
- e) dokumentacion mbi gjendjen e llogarisë, lëshuar nga Abi Bank;
- f) DIPP-të për vitet 2015 dhe 2016 të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur;
- g) kërkesa për transferim fondesh me veprimet përkatëse, lëshuar nga NBG Bank;
- h) praktika e dokumenteve mbi përfitimimin e bursës në favor të A. H., lëshuar nga Universiteti {***}, Itali, në gjuhët italiane dhe angleze; si dhe
- i) tabela përmbledhëse për periudhën 1993-2016, që i bashkëngjitet këtij ankim.

Më datë 29.06.2023, në Kolegj, janë depozituar parashtrimet e subjektit të rivlerësimit Enrik Haxhiraj, në funksion të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi të datës 05.07.2023, të cilat janë protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot. Bashkëngjitur parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit solli dokumente, të cilat kërkoi t'i administrohen në cilësinë e provës, si vijon:

- a) vërtetim nr. {***} prot., datë 21.06.2023, i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; dhe
- b) fotokopje e faqes 21 të vendimit të Komisionit.

11.3 Këto akte u vlerësuan nga trupi gjykues të panevojshme për zgjidhjen e çështjes dhe se fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen e Kolegjit. Bazuar në parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, parashikohet: *“Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj, si dhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: “Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: (a) marrja e provës duket se është e panevojshme; (b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...] (d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit”*. Në verifikim të parashikimeve ligjore, në rastin konkret vlerësohet se aktet e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, një pjesë e të cilave janë të administruara³ në dosjen e Komisionit, përveç se nuk mbështeten mbi fakte që provojnë mospasjen mundësi të paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ në Komision, siç kërkon zbatimi i nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, por edhe sikur të ishin në plotësim të këtyre kritereve, nuk konsiderohen të nevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për më tepër edhe sikur të konsideroheshin me vlera të plota provuese në drejtim të fakteve që subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë nëpërmjet tyre, përsëri nuk ndikojnë në marrjen e vendimit, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

³ Aktet e numërtuara 1 dhe 6 në paragrafin 11.2 më sipër, gjenden të administruara në dosjen e Komisionit.

11.4 Në vlerësim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj, me praninë e subjektit të rivlerësimit për korrigjimin e tyre. Në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, gjykimi në Kolegj, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezultoi i nevojshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike për t'i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar edhe në Kolegj. Kjo edhe për faktin se kërkimi që paraqet subjekti i rivlerësimit, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, nuk parashikohet në rastet specifike ligjore, sipas kërkesave të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Gjithashtu, Kolegji vlerësoi kryesisht se: (a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; (b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; si dhe (c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

11.5 Kolegji, në konkluzion të arsytimit të mësipërm, vlerësoi si të pabazuar në ligj kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ndaj vendosi të vijojë ta shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit

12. Lidhur me analizën financiare të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit paraqet pretendimet e tij si vijojnë.

i) Sa i përket të ardhurave të gjeneruara nga aktiviteti privat i bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është i paarsyetuar, pasi nuk i është dhënë përgjigje pretendimeve të tij, argumenteve ligjore dhe konkluzioneve të Raportit të Audituesit Ligjor, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 49 të ligjit nr. 86/2016. Për analizën financiare të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit pretendon se është provuar mungesa e informacionit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë (në vijim "DRT"), për të dhënat e aktivitetit të noterisë, për të cilin Komisioni nuk ka përllogaritur në mënyrë të saktë normën e fitimit nga aktiviteti i bashkëshortes së tij, duke i konsideruar si normë mesatare fitimi 75% të xhiros në vitin 2006. Sipas subjektit të rivlerësimit për vitin 2006 të ardhurat nga aktiviteti i noterisë janë në shumën 2.000.000 lekë, shpenzimet janë në masën 111.908 lekë dhe fitimi i llogaritur rezulton në masën 1.888.092 lekë. Sipas kësaj përllogaritje, situata financiare e vitit 2006, sipas subjektit, rezulton me diferencën negative (-) 81.482 lekë dhe jo (-) 345.873 lekë sa i ka rezultuar Komisionit.

ii) Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit se nuk ka pasur burime të ligjshme për investimin gjatë vitit 2006 për pasurinë shtëpi banimi të ndodhur në lagjen "{***}", Vlorë, pasi mungesa e fondeve është vetëm në shumën (-) 81.482 lekë, duke mos pranuar diferencën negative të rezultuar nga analiza e Komisionit prej (-) 345.873 lekësh. Subjekti pretendon se ka pasur mundësi financiare për të justifikuar plotësisht investimin e kryer në shumën 443.200 lekë, në vitin 2006, për shtëpinë e banimit.

iii) Subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit për të moskonsideruar gjendjen *cash* të padeklaruar si shtesa e pakësime para vitit 2006 në deklaratat periodike të pasurisë, duke mos marrë në konsideratë pretendimin e tij se kjo ka ndodhur për arsye të konceptimit të gabuar të deklaratave në vitet e para të deklarimit dhe se subjekti ka pasur mundësi për krijimin e likuiditeteve *cash*.

12.1 Ankimi i subjektit të rivlerësimit, për kriterin e pasurisë, është ndërtuar në mënyrë të tillë që nuk ka kundërshtuar konkluzionet, sipas vendimit të Komisionit referuar pasurive të cilat kanë qenë objekt kontrolli në Komision, por ka ngritur shkaqe dhe paraqitur pretendime bazuar në konkluzionet e Komisionit për analizën financiare të viteve. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit ka ngritur shkaqet e ankimit bazuar në konkluzionin e Komisionit, në paragrafin 165.2 të vendimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të paraqiten me pamundësi financiare për të justifikuar plotësisht me të ardhura nga burime financiare të ligjshme pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera për vitet 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2013 dhe 2014, të pasqyruara balancat negative të fondeve si vijon: (i) viti 2006 – balanca negative e fondeve (-) 345.873 lekë; (ii) viti 2007 – balanca negative e fondeve (-) 69.047 lekë; (iii) viti 2008 – balanca negative e fondeve (-) 1.572.688 lekë; (iv) viti 2009 – balanca negative e fondeve (-) 2.413.581 lekë; (v) viti 2010 – balanca negative e fondeve (-) 3.935.063 lekë; (vi) viti 2011 – balanca negative e fondeve (-) 706.992 lekë; (vii) viti 2013 – balanca negative e fondeve (-) 1.164.816 lekë; si dhe (viii) viti 2014 – balanca negative e fondeve (-) 731.656 lekë. Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit ka renditur shkaqet, sipas pretendimeve për vitet që Komisioni i ka konkluduar me balancë negative. Për këtë arsye, edhe shqyrtimi i shkaqeve të ankimit në Kolegj i është nënshtruar të njëjtit rend dhe mënyrë, siç i ka ankuar subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, kontrolli i analizës financiare të kryer në Komision është kryer bazuar në pretendimet e paraqitura në ankim, duke verifikuar në këtë mënyrë ndikimin e fitimit *neto* të personit fizik, sipas deklarimeve që ka bërë personi i lidhur në organet e tatimeve, në pasuritë dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit. Konkluzionet e Komisionit, të cilat nuk janë ankimuar nga subjekti i rivlerësimit nuk i janë nënshtruar kontrollit dhe, si të tillë, ato mbeten të pandryshuar.

12.2 Për shkak të mënyrës se si janë administruar nga personi i lidhur [bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit], llogaritë bankare personale dhe llogaritë bankare të personit fizik [duke përzier në to kreditimet nga të ardhurat, personale/fitimi, me ato të rrjedhura nga transaksionet e aktivitetit të personit fizik], pashmangshmërisht këto llogari iu nënshtruan verifikimit të burimit të krijimit të tyre dhe, më tej, u vlerësua efekti/ndikimi i tyre në krijimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur.

12.3 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *të ardhura nga fitimi i ushtrimit të aktivitetit të noterisë së bashkëshortes sime I. B., nga data 07.08.1994 dhe deri më datë 31.12.2016, regjistruar si tatim pages me NIPT {***}. Emërimi Notere në bazë të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 45, datë 07.08.1994 [...]. Qarkullimi është në shumën 93.594.254 lekë. Në deklaratën e para fillimit të punës në vitin 2003 subjekti i rivlerësimit deklaroi të ardhura të realizuara nga bashkëshortja si notere [...] detyrime fiskale 120.000 lekë [...] shuma neto në lekë 2.000.000 lekë. Gjithashtu, në të gjitha deklaratat periodike, ka deklaruar të ardhurat përkatëse sipas viteve.*

12.4 Komisioni ka marrë në analizë burimet e kryerjes së investimit për ndërtesën e subjektit të rivlerësimit me sip. 184,34 m², në bashkëpronësi me bashkëshorten e tij, ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, pasi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me analizën financiare në këto vite, japin efektin e tyre në kontrollin e të gjitha burimeve që kanë shërbyer për investimet e kryera, ku bëjnë pjesë edhe të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti noterial. Kjo ndërtesë, sipas deklaramit në deklaratën *vetting*, rezulton të jetë 4-katëshe me këto të dhëna: (i) sipërfaqja e katit nëntokë 60 m²; (ii) sipërfaqja e katit përdhe 184 m²; (iii) sipërfaqja e katit të parë 176 m²; dhe (iv) sipërfaqja e katit të dytë 65 m². Subjekti në deklaratën *vetting* ka deklaruar se kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore është bërë në datën 09.02.2011 dhe se për godinën është nxjerrë leja e legalizimit në datën 27.04.2011. Si vlerë investimi ka deklaruar shumën 18.081.280 lekë, referuar vlerës së përcaktuar në formularin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë. Vlera e paguar e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në shumën 180.812 lekë. Vlera totale e parcelës ndërtimore është 3.400.000 lekë, nga të cilat paguar me bono privatizimi shuma 1.780.000 lekë dhe me lekë shuma 1.620.000 lekë. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim krijimi të kësaj pasurie.

12.5 Në deklaratën e para fillimit të punës në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit “shtëpi banimi” në ndërtim e sipër, në bashkëpronësi me bashkëshorten, pa vlerë të deklaruar, të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: *“Nga të ardhurat e mia vjetore, të ardhurat e përfituara nga veprimtaria e bashkëshortes si notere, nga marrëdhënia e huas, si dhe nga kredia bankare”*. Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Huamarrje 20.000 euro dhe 10.000 dollarë nga firma “{***}” ShPK, me qendër në Vlorë, me administrator z. V. M.”*. Në rubrikën “Arsyeja e krijimit të detyrimit”, subjekti ka shënuar për ndërtimin e shtëpisë së banimit. Gjithashtu, subjekti si detyrim financiar ka deklaruar edhe kredinë bankare në shumën 40.000 euro dhe si arsye të krijimit të këtij detyrimi ka deklaruar se ka investuar themelet për ndërtimin e pasurisë së paluajtshme, shtëpisë së banimit.

12.6 Subjekti i rivlerësimit në vitin 2006 nuk rezulton të ketë deklaruar shpenzime për kryerjen e investimit në shtëpinë e banimit të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë. Këto shpenzime janë deklaruar gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, siç do të detajohet në paragrafët në vijim.

12.7 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se ZVRPP-ja Vlorë ka konfirmuar, me shkresën nr. {***} prot., datë 19.02.2019, se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria e llojit “truall”, me sipërfaqe 500 m² dhe “ndërtesë” me sipërfaqe 184 m², “godinë banimi 4 kate”. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje për këtë pasuri rezulton se në datën 27.04.2011 nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Vlorë është nxjerrë leja e legalizimit, sipas së cilës nga sipërfaqja e parcelës ndërtimore prej 500 m², sipërfaqja totale e ndërtimit është 184 m², numri i kateve mbi tokë është 3 (tre) dhe numri i kateve nëntokë është 1 (një). Nga kartela e regjistrimit të kësaj pasurie në zyrën e regjistrimit të pasurisë rezulton se: (i) sipërfaqja e katit nëntokë është 60 m²; (ii) sipërfaqja e katit përdhe është 184 m²; (iii) sipërfaqja e katit të parë është 176 m²; dhe (iv) sipërfaqja e katit të dytë është 65 m².

12.8 Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 3 të Komisionit, është pyetur për kohën e saktë të fillimit të punimeve, ecurinë e ndërtimit të objektit deri në datën 31.12.2003, vlerën e

investuar deri në këtë datë, si dhe burimin përkatës të të ardhurave për këtë investim. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se koha e fillimit të punimeve për ndërtimin e shtëpisë ka qenë nga data 21.05.2002 deri më 31.12.2002, që është përfunduar faza e parë e ndërtimit të konstruksionit të shtëpisë së banimit në vlerën 6.666.202 lekë. Në fazën e dytë, nga data 03.01.2003 deri më datë 31.12.2003, janë kryer punime rifiniture, instalime elektrike, hidraulike, veshje të pjesshme të fasadës, në total 5.000.000 lekë. Në fazën e tretë, nga data 03.01.2004 deri në muajin tetor 2004, janë kryer punime rifiniture (shtresë pllakash, vendosje vetratash, hidrosanitare, punime aksesorëve elektrikë, dyer të brendshme, veshje mermeri, lidhja me ujin e pijshëm dhe energji elektrike etj.), në total në shumën 5.000.000 lekë.

12.9 Në pyetësin nr. 3, subjekti ka shpjeguar edhe për investime të tjera të kryera për ndërtesën 4-katëshe të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, si vijon: (i) gjatë vitit 2005 në vlerën 488.000 lekë; (ii) gjatë vitit 2006 në vlerën 443.200 lekë; (iii) gjatë vitit 2007 në vlerën 502.700 lekë; dhe (iv) gjatë vitit 2008 në vlerën 516.800 lekë. Si burim për investimet e kryera përgjatë viteve 2005 – 2008 ka deklaruar të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti i noterisë. Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ konstatoi se këto investime nuk janë deklaruar në DIPP-të vjetore të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI. Të gjitha këto vlera investimesh të deklaruara nga subjekti, Komisioni i pasqyroi si shtesë pasurie në periudhat përkatëse, në analizën financiare përmbledhëse. Nga analiza në rezultatet e hetimit paraprak të kryer nga Komisioni ka rezultuar se vitet 2006, 2007 dhe 2008 paraqiten me balancë negative fondesh, si rrjedhojë është konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht investimet e kryera, të vetëdeklaruara për vitet 2006, 2007 dhe 2008, për pasurinë objekt vlerësimi.

12.10 Kolegji vëren se për arsyen e pamjaftueshmërisë së cituar në paragrafin më sipër, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe për të depozituar prova të reja të mundshme, lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për këto vite. Me prapësimet e depozituara pas rezultateve të hetimit, lidhur me analizën e treguesve financiarë për vitet 2006, 2007 dhe 2008, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar përlllogaritje më të lartë të të ardhurave *neto* nga fitimi i realizuar nga aktiviteti i bashkëshortes për këto vite, duke pretenduar, gjithashtu, se ka pasur mundësi krijimi të kursimeve në gjendje likuiditetesh *cash* gjatë vitit 2005, të cilat i ka përdorur në vitin 2006. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar investimin e kryer për shtëpinë e banimit në DIPP-në e vitit 2006 dhe as në vitet 2005, 2007 dhe 2008, shpenzim i cili rezultoi i deklaruar prej tij vetëm në pyetësin nr. 3 të Komisionit, duke deklaruar vlerat përkatëse të investimit që i përkasin këtyre viteve. Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin, që në kuadër të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), të deklarojë ndryshimet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në fund të çdo viti kalendarik, pasi trupi gjykues vlerësoi se këto investime janë kapitalizuar në formën e shtesës së pasurisë së paluajtshme. Në DIPP-në e vitit 2005, në faqen 3 të saj, në rubrikën e deklarimit të interesave private, pasuritë e paluajtshme e të luajtshme është shënuar *përshkrimi i hollësishëm i shtesave dhe pakësimeve në çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme të regjistruar ose jo [...]*. Në këtë kontekst edhe investimi i kryer nga subjekti i rivlerësimit në vitet 2005, 2006, 2007 dhe 2008, i cili nuk ka gjetur pasqyrim në deklaratat periodike që i përkasin këtyre viteve, duhej të deklarohet si

shtesë pasurie e paluajtshme. Mosdeklarimi i këtij investimi në kohë, sipas ligjit nr. 9049/2003, sjell pamundësinë e kryerjes së kontrollit dhe vlerësimit të kësaj situate, sipas përcaktimeve në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi për rivlerësimin kalimtar, duke i lënë pretendimet e subjektit të rivlerësimit në nivelin e deklarimeve, vërtetësia e të cilave mbetet e pamundur për t'u verifikuar. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike fokusojnë objektin e kontrollit në drejtim të verifikimit në vijim të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të disponueshme për justifikimin e këtyre punimeve. Kolegji e gjeti të drejtë pasqyrimin në analizën financiare të Komisionit të vlerës së investimit për vitin 2006, sipas përgjigjeve që subjekti ka dhënë në pyetësonin nr. 3 të Komisionit, për këto investime.

12.11 Komisioni, bazuar në dokumentacionin e administruar për subjektin "I. B.", person fizik, analizuar në harmoni me legjislacionin e kohës dhe të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti tregtar, vlerësoi që për vitet 2006 dhe 2007 të njohë si normë fitimi masën prej 75% mbi qarkullimin e deklaruar për këtë periudhë. Në dokumentacionin e administruar në dosje rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision aktin me titull "*Raporti i audituesit ligjor*", i hartuar nga A. M., me kërkuar subjektin e rivlerësimit.

- Sipas këtij raporti⁴ për vitet 1994-2007 ngarkesa fiskale e Tatimit të Thjeshtuar të Fitimit ka qenë duke filluar nga 4% duke zbritur në 1.5%.

- Për periudhën 2008-2010 ngarkesa fiskale e Tatimit të Thjeshtuar të Fitimit është 10%.

- Për vitet 2010-2014 ngarkesa fiskale e Tatimit të Thjeshtuar të Fitimit ka qenë duke filluar nga 10% dhe TVSH 20%.

- Në vitin 2014 e në vijim ngarkesa fiskale e tatimit mbi fitimin është 15% dhe TVSH 20%.

Audituesi ligjor ka shpjeguar në raportin e tij se për të gjithë veprimtarinë e biznesit të bashkëshortes së subjektit, masa e ngarkesës fiskale ka qenë nga 1.5% në 35%, duke ndikuar në normën e fitimit në periudha të ndryshme.

12.12 Kolegji vëren se lidhur me rezultatin financiar të vitit 2006, audituesi ligjor ka kryer analizën bazuar në përcaktimet ligjore për biznesin e vogël, përkatësisht përcaktimet e ligjit nr. 9431⁵, datë 13.10.2005, "Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, i cili parashikon se shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar të fitimit është 1.5%. Sipas tij, në mungesë të të dhënave për shpenzimet që nevojiten për këtë biznes, është bazuar në të dhënat e dosjes së ILDKPKI-së, deklaratës *vetting*, deklaratave tatimore dhe urdhërpagesave për të kryer përlllogaritjen e nevojshme për shpenzimet ushtrimore. Për shpenzimet e materialeve ndihmëse për aktivitetin, audituesi ligjor është bazuar në ecurinë e numrave rep/kol të regjistruarë noterialë për të llogaritur sasinë me çmimet, sipas zërave përkatës.

Për vitin 2006, sipas regjistrit noterial, ecuria në regjistrin noterial e numrave rep/kol rezultoi në shifrën 1409 veprime noteriale.

Për të përlllogaritur fitimin *neto* nga aktiviteti i noterisë për vitin 2006, audituesi ligjor i ka zbritur qarkullimit vjetor prej 2.000.000 lekësh, shpenzimet në vlerën 111.908 lekë dhe ka arritur në përfundimin se fitimi *neto* për vitin 2006 është në vlerën 1.888.092 lekë, duke vlerësuar kështu një normë fitimi për këtë vit në masën 89.56%.

⁴ Faqe nr. 5 e raportit të audituesit ligjor.

⁵ Neni 1: Pika 1 e nenit 32/3 ndryshohet si më poshtë: "1. Shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është 1,5 për qind".

12.13 Nga analiza e kryer nga Komisioni për vitin 2006, bazuar në dokumentacionin e administruar për subjektin “I. B.”, person fizik, analizuar në harmoni me legjislacionin e kohës dhe të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti tregtar është përlllogaritur një fitim në vlerën 75% të xhiros, i cili për vitin 2006 rezulton në vlerën 1.500.000 lekë.

Në verifikimin e analizës së kryer nga audituesi ligjor për vitin 2006 nuk rezultojnë të përlllogaritura shpenzime për materiale kancelarie, shpenzime për mirëmbajtje dhe, gjithashtu, nuk janë përlllogaritur në këtë analizë edhe shpenzimet për energji elektrike⁶, ashtu siç janë përlllogaritur për vitin 2004. Shpenzimet për kancelari apo mirëmbajtje të pajisjeve që përdoren në zyrën e noterisë dhe ato për energjinë elektrike natyrisht janë shpenzime të përvitshme dhe të qenësishme për këtë lloj aktiviteti. Këto shpenzime janë pranuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit si shpenzime të veprimtarisë së noterisë. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, bazuar në metodologjinë e analizës së përgatitur nga audituesi ligjor, në Kolegj u përfshinë në tabelën financiare të vitit 2006, edhe zërat e mësipërm të shpenzimeve, referuar zërave të shpenzimeve për vitin 2004. Në Kolegj, bazuar në metodologjinë e mësipërme, për personin fizik “I. B.” për vitin 2006, rezultoi një marzh fitimi në masën 80.24%, i cili dha ndikimin e tij në analizën financiare të kryer për këtë vit nga Komisioni, në zërin e fitimit *neto* mbi qarkullimin e aktivitetit noterial të bashkëshortes.

12.14 Lidhur me gjendjen *cash* në banesë të padeklaruar nga subjekti i rivlerësimit si shtesa e pakësime para vitit 2006 në deklaratat periodike të pasurisë, Komisioni ka konkluduar se [...] *për sa kohë në deklaratat periodike vjetore para vitit 2006 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesë pasurie gjendje likuiditetesh cash, nuk mund të merret në konsideratë pretendimi i tij se ai ka pasur mundësi për krijim gjendjeje likuiditetesh cash në fund të vitit 2005 e të përdorur në vitin 2006, pasi ky pretendim është krejtësisht i karakterit deklarativ dhe i pambështetur në prova.*

12.15 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se nuk ka deklaruar gjendjen *cash* për arsye të konceptimit të gabuar të deklarimit dhe për arsye se kanë qenë vitet e para të deklarimit. Sipas subjektit, kjo pasaktësi nuk kishte për qëllim deklarimin e rremë apo fshehjen e pasurisë, duke qenë se pasuria është krijuar me të ardhura të ligjshme dhe shuma e akumuluar e këtyre viteve është mbartur dhe është përdorur në vitet me balancë negative duke filluar në vitin 2006. Sipas subjektit të rivlerësimit, moskonsiderimi nga Komisioni i të ardhurave *cash* vetëm se subjekti nuk i ka deklaruar ato, përbën një penalizim jo në proporcion me mospërmbushjen e detyrimit formal nga subjekti, duke tejkaluar kështu frymën e ligjit nr. 84/2016, që synon ndëshkimin e mungesës së burimeve të ligjshme dhe pamjaftueshmërisë thelbësore të deklarimeve, me anë të së cilës mund të jetë tentuar apo realizuar pasqyrimi i një gjendje pasurore të deklaruesve e ndryshme nga realiteti. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që të marrë në konsideratë faktin e përdorimit të një pjesë të likuiditeteve *cash* të vitit 2006 të kursyera nga vitet e mëparshme.

12.16 Subjekti i rivlerësimit edhe pse pretendon se ka pasur gjendje *cash* në banesë, në analizën e bërë prej audituesit të tij ligjor, të paraqitur në Komision dhe gjithashtu në Kolegj, nuk e ka pasqyruar shtesën apo pakësimin e likuiditeteve *cash* në këto vite. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe i deklaratave të pasurisë të deklaruar vit pas viti në ILDKPKI, nuk rezulton të jenë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit shtesa apo pakësime të gjendjes *cash* në banesë apo deklarim i përdorimit të të ardhurave të viteve të mëparshme si

⁶ Shpenzimet për kancelari, mirëmbajtje dhe energji zënë rreth 72% të totalit të shpenzimeve ushtrimore të aktivitetit të noterisë për vitin 2006.

burim për krijim pasurie apo mbulim shpenzimesh në vitet përkatëse. Nga analiza financiare e viteve 2003, 2004 dhe 2005 rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur tepricë pozitive ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, por duke mos pasur deklarim të saktë të gjendjes së *cash-it* vit pas viti, mosdeklarim të shpenzimeve për investim në vitet 2006, 2007 dhe 2008, si dhe burimin e mbulimit të këtij shpenzimi, është e pamundur të përllogaritet sa mund të ketë qenë kursimi i saktë në secilin vit dhe nëse ai ka shërbyer si burim për mbulimin e këtyre investimeve.

12.17 Trupi gjykues sjell në vëmendje praktikën e konsoliduar të Kolegjit⁷, e cila ka vlerësuar deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratimet periodike të interesave, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklaratimit, në rubrikën përkatëse, faqja 3 e formularit, që i përket pasqyrimit të shtesave dhe ndryshimeve të interesave privatë dhe pasurive të paluajtshme e të luajtshme, ligji në mënyrë konsistente ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për [...] *ndryshimet (shtesa dhe pakësime)* nga “*deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklaratimit*” që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë [...]. Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë, duke parashikuar që deklaratat përbëjnë dokumente zyrtare dhe mospërmbushja e këtij detyrimi sillte pasoja për subjektet deklaruese.

12.18 Nga rrethanat dhe faktet më sipër, rezultoi se argumentet e subjektit të rivlerësimit Enrik Haxhiraj bien ndesh me detyrimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit, të përcaktuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e subjektit dhe të personave të lidhur, në funksion të vazhdimit të qëndrimit në detyrë, sikurse edhe me detyrimet ligjore të subjektit si funksionar publik, subjekt i ligjit nr. 9049/2003. Konkretisht, plotësimi me saktësi dhe vërtetësi i deklaratës *vetting* ka rëndësi në zbatimin e duhur të kuadrit ligjor (neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016), si dhe nënligjor (Udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i ILDKPKI⁸-së). Këto rregullime kërkojnë që subjektet e rivlerësimit të deklarojnë me vërtetësi pasurinë, në rastin konkret likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar, investimin e kryer në vitin 2006 në shtëpinë e banimit në “{***}”, Vlorë [si ndryshim pasurie të paluajtshme], si dhe burimin për mbulimin e shpenzimeve për këtë investim me qëllim që të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit dhe të mos ketë përpjekje për fshehje apo pasqyrim të pasaktë.

12.19 Në vlerësim të sa më sipër, duke konsideruar edhe praktikën⁹ e konsoliduar të Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se bazuar në ligjin nr. 9049/2003, në nenin 4, shkronja “d”, parashikohet se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në

⁷ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 11/2019 (JR); nr. 19/2019 (JR); nr. 20/2019 (JR) dhe nr. 27/2020 (JR).

⁸ Udhëzimi “Për mënyrën e deklaratimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” – pika 17: “Deklarimi i gjendjes “cash” do të njihet si i tillë në konceptin e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, deri në kufirin e shumës 1,5 milionë lekë. Shumat më të mëdha duhet të formalizohen në sistemin bankar, përpara dorëzimit të deklaratës në ILDKPKI, duke bashkëlidhur në çdo rast vërtetimin bankar për këtë veprim”.

⁹ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 20/2020, datë 08.09.2020, paragrafi 19.4.

huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve *cash* në banesë, jashtë sistemit bankar. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar dhe investimin e kryer në vitin 2006, si një vlerë që kapitalizohej në vlerën e pasurisë shtëpi banimi në “{***}”, Vlorë, duke shtuar vlerën e kësaj pasurie, si dhe burimin për mbulimin e shpenzimeve për këtë investim. Pasaktësitë, për të cilat subjekti justifikohet gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, se ka pasur perceptim të gabuar të deklarimit në vitet e para, vërtetësia e të cilave mbetet e pamundur për t’u verifikuar, rezulton se shoqërohen me mungesën e burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe krijimin e pasurive në vitin 2006, për më tepër që edhe në analizën financiare të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk janë parashikuar shtesa e pakësime të gjendjes së likuiditeteve *cash*. Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në shumën (-) 241.001 lekë, duke plotësuar kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

13. Lidhur me analizën financiare të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit paraqet pretendimet si vijojnë.

i) Sa i përket të ardhurave të gjeneruara nga aktiviteti privat i bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit kundërshton mënyrën e përlllogaritjes së fitimit nga aktiviteti privat i bashkëshortes së tij. Sipas tij, bazuar edhe në aktin e ekspertimit të hartuar nga audituesi ligjor, për këtë vit, kompetencat për administrimin e taksës vendore i kanë kaluar zyra të Njësive të Qeverisjes Vendore, ndërsa përgjegjësia tatimore e tatimit të thjeshtuar për vitin 2007 është shfuqizuar dhe të dhënat për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti, bashkëshortja e subjektit i ka deklaruar në zyrën e Taksave Vendore të Njesisë së Qeverisjes Vendore. Sipas subjektit, Komisioni ka përlllogaritur normën e fitimit të bashkëshortes për vitin 2007 në masën 75% e xhiros, por audituesi ligjor ka kryer një analizë më të thelluar dhe ka dalë në përfundimin se fitimi për këtë vit i aktivitetit të bashkëshortes së tij ka qenë në shumën 2.842.967 lekë, duke pretenduar se edhe Komisionit, ashtu si audituesi ligjor, duhet t’i kishte dalë rezultat financiar pozitiv në shumën 40.281 lekë për vitin 2007, dhe jo rezultati negativ prej (-) 69.047 lekësh.

ii) Në lidhje me huan e marrë nga personi i lidhur V. M., subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se huadhënësi nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të dhënë shumën prej 20.000 eurosh. Ai pretendon se i ka marrë këtij shtetasi shumën 20.000 euro nëpërmjet kontratës noteriale të huas në vitin 2002, duke argumentuar se ka paraqitur në Komision një sërë provash, pavarësisht prej kohës së gjatë të kaluar, për të vërtetuar se personi tjetër i lidhur ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë huan.

iii) Në lidhje me investimin gjatë vitit 2007, për pasurinë “godinë 3-katëshe”, të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar konkluzionin e Komisionit se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të kryer këtë investim, duke qenë se nga analiza e paraqitur prej tij për vitin 2007 ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar, pasi sipas tij rezulton me balancë pozitive në shumën 40.281 lekë.

13.1 Komisioni për vitin 2007 ka arritur në konkluzionin se balanca negative është në shumën (-) 69.047 lekë. Fillimisht, në rezultatet e hetimit paraprak, Komisioni ka arritur në përfundimin se viti 2007 rezultonte me balancë negative në shumën (-) 1.812.702 lekë, për shkak se të ardhurat nga fitimi *neto* i aktivitetit të noterisë të bashkëshortes së subjektit për këtë vit i kishte

llogaritur në shumën 506.345 lekë. Pas dëgjimit në seancë dëgjimore të pretendimeve të subjektit, Komisioni ka reflektuar të ardhurat nga aktiviteti i noterisë për këtë vit, duke i rillogaritur dhe duke i rezultuar në shumën 2.250.000 lekë (Komisioni i ka llogaritur fitimin *neto* për vitin 2007=75.00%, fitim të cilin Komisioni e ka marrë me rezervë të mesatarizuar për të gjithë periudhën 1994-2007).

13.2 Në lidhje me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se për analizën financiare të bazohemi në analizën e kryer nga audituesi ligjor në raportin e dorëzuar në Komision. Sipas kësaj analize, në vitin 2007, rezulton se për të llogaritur shpenzimet për zhvillimin e aktivitetit noterial është bazuar në ecurinë e numrit rep/kol në regjistrat noterialë të kryer për vitin 2007, i cili ka rezultuar në një total prej 1.754 njësisish. Nga analiza e kryer nga audituesi ligjor ka rezultuar se shpenzimet për aktivitetin noterial për vitin 2007 kanë qenë në shumën 157.033 lekë, duke përfshirë shpenzimet për blerje letre, shpenzimet për blerje regjistrash noterialë, për energji eklektike, për tatimin për biznesin e vogël, për taksat vendore, si dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Në analizën e kryer nga audituesi ligjor për vitin 2007 nuk rezultojnë të përllogaritura shpenzime për kancelari dhe shpenzime për mirëmbajtje, siç është llogaritur nga vetë ai në vitin 2004. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, të ushtruar në Kolegj, u përfshinë¹⁰ në tabelën financiare të vitit 2007, edhe zërat e mësipërm të shpenzimeve, sipas së njëjtës metodologji të kryer nga audituesi ligjor, referuar zërave të shpenzimeve për vitin 2004. Siç u theksua edhe më lart, shpenzimet për kancelari apo mirëmbajtje të pajisjeve që përdoren në zyrën e noterisë janë shpenzime të përvitshme dhe të qenësishme për këtë lloj aktiviteti, të pranuar si të tilla edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, si rrjedhojë u përllogaritën edhe në Kolegj në analizën financiare të vitit 2007.

13.3 Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, ushtruar nga Kolegji, rezultoi se xhiro e aktivitetit noterial e deklaruar në vitin 2007 është në shumën 3.000.000 lekë, të cilës i janë zbritur shpenzimet e vitit 2007 në vlerën 421.033 lekë e, si rrjedhojë, aktiviteti privat i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit do të rezultonte me fitim *neto* në shumën 2.578.967 lekë. Përqindja e fitimit në këtë rast është përllogaritur në masën 85.97%, ndryshe nga audituesi ligjor që e ka përllogaritur fitimin në masën 94.77%, ndërsa Komisioni me 75%.

13.4 Lidhur me huan e marrë nga V. M. në vitin 2002 dhe shlyer në vitin 2007, subjekti argumenton në ankim se edhe pse Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë si burim të ligjshëm këtë hua, në analizën e detajuar financiare për periudhën 01.01.2002 - 31.12.2002 të kryer prej Komisionit, balanca e fondeve të këtij viti (ku përfshihet investimi për shtëpinë e banimit në shumën 6.666.202 lekë) ka rezultuar pozitive. Subjekti parashtron, gjithashtu, se marrëdhënien e huas me personin tjetër të lidhur V. M., të lidhur në vitin 2002, e kanë formalizuar me akt noterial dhe subjekti e ka deklaruar këtë marrëdhënie, si në deklaratën fillestare të vitit 2003, ashtu edhe në deklaratën *vetting*.

13.5 Komisioni, lidhur me këtë huamarrje, ka arsyetuar se *rezulton se subjekti ka kryer deklarime të pasakta/kontradiktore lidhur me huadhënësin, pasi, bazuar në deklaratën fillestare dhe shpjegimeve të dhëna prej tij në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ai referon si*

¹⁰ Shpenzimet për kancelari dhe mirëmbajtje zënë rreth 63% të totalit të shpenzimeve ushtrimore të aktivitetit të noterisë për vitin 2007.

huadhënës shoqërinë “{***}” ShPK, ndërsa referuar kontratës, si huadhënës ka nënshkruar V. M.j [...].

Subjekti ka depozituar dokumentacion lidhur me xhiron e deklaruar të shoqërisë “{***}” ShPK, për vitet 2001 dhe 2002, por nuk ka provuar fitimin neto të kësaj shoqërie dhe, për më tepër, nuk ka provuar nëse kjo shoqëri ka shpërndarë dividend, duke konsideruar faktin që në atë kohë kishte dy aksionerë, njëri prej të cilëve shtetasi V. M.. [...].

Nga hetimi administrativ i kryer për personin tjetër të lidhur rezulton se në datën 20.11.2000 ky individ ka blerë një automjet në shumën 2.000.000 lekë dhe se, gjithashtu, në kohën e dhënies së huas ka pasur të depozituar në bankën “Italo-Shqiptare” shumën 3.450.000 lekë. Për sa më sipër, rezulton se personi tjetër i lidhur, shtetasi V. M., nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar dhënien e huas në datën 29.04.2002, në favor të subjektit të rivlerësimit, në shumat 20.000 euro dhe 10.000 dollarë. [...] Në përputhje me nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit/personi tjetër i lidhur nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave, të cilat pretendohen se kanë shërbyer për krijimin e vlerave të dhëna hua në favor të subjektit të rivlerësimit në datën 29.04.2002, të ardhura këto të deklaruara si burim krijimi për investimet e kryera gjatë fazës së parë dhe fazës së dytë, për pasurinë objekt vlerësimi. [...].

Si rrjedhim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

13.6 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se më datë 29.04.2002 është lidhur kontratë huaje¹¹, në të cilën përcaktohet se individi V. M., në cilësinë e huadhënësit, i cili vepron në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, deklaroi se jep në favor të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij (në cilësinë e huamarrësve) shumat 20.000 euro dhe 10.000 dollarë, pa afat të përcaktuar në kohë (meqenëse ky raport bazohet në besimin reciprok për shkak të marrëdhënies së posaçme familjare, pasi huadhënësi rezulton të jetë bashkëshorti i hallës së huamarrëses). Në këtë kontratë parashikohet se qëllimi i marrjes së huas do të jetë përdorimi i saj si investim për ndërtimin e një shtëpie banimi për strehim, në lagjen “{***}”, Vlorë. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e një pjese të huas në DIPP-në e vitit 2004 në masën 10.000 USD dhe 5.000 euro, kundrejt shoqërisë “{***}” ShPK, me administrator V. M.. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e huas në shumën 10.000 euro, si detyrim ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, me administrator V. M.. Në këto kushte, sipas kontratës së huas, si dhe referuar deklarameve periodike cituar më sipër, është shlyer vetëm 15.000 euro dhe 10.000 USD, ku rezulton se kanë mbetur pa shlyer edhe 5.000 euro, të cilat në deklaratat periodike pasardhëse nuk rezultojnë të deklaruara nga subjekti si të shlyera.

13.7 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se *ndonëse midis meje dhe subjektit të rivlerësimit Enrik Haxhiraj dhe bashkëshortes sime I.B., me z. V. M. ka ekzistuar dhe ekziston një lidhje e posaçme familjare, pasi huadhënësi është bashkëshorti i shtetases T. M., hallës së bashkëshortes, marrëdhënia jonë e huas e vitit 2002 rezulton se është formalizuar zyrtarisht me akt noterial “Kontratë huaje”, datë 29.04.2002. [...] Komisioni ka*

¹¹ Vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., datë 29.04.2002, që konfirmon kontratën e huas.

pranuar se z. V. M. ka pasur të regjistruar në emrin e tij si individ një tërësi mjetes transporti për të cilat subjekti ka depozituar dokumentacion.

13.8 Lidhur me burimin e të ardhurave të z. V. M., si person tjetër i lidhur, për shkak të marrëdhënies së huas së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe detyrimit për efekt të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave, të cilat kanë mundësuar dhënien e huas, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision deklaratën noteriale, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.06.2016, në të cilën V. M. deklaroi se ushtron prej 25 vitesh aktivitetin privat të transportit të mallrave dhe se me të ardhurat e siguruara prej aktivitetit të tij privat i ka dhënë hua subjektit dhe bashkëshortes së tij shumë prej 20.000 eurosh dhe 10.000 USD. Deklaruesi sqaron se kjo shumë i është likuiduar mbas vitit 2002 në vlera të ndryshme me këste të herëpashershme nga huamarrësit deri në fund të vitit 2007, kur përfundoi plotësisht likuidimi i huas prej tyre. Bashkëngjitur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit subjekti ka paraqitur edhe deklaratën noteriale, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2021, në të cilën sqarohet se deklaruesit T. dhe V. M. ushtrojnë aktivitet privat që nga viti 1991 dhe kanë gjeneruar të ardhura të konsiderueshme duke krijuar llogari dhe depozita, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Znj. T. M. deklaroi se pagën e saj të gjeneruar nga ky aktivitet e ka kursyer si një fond personal kursimi. Z. V. M. deklaroi se prej vitit 1999 është ortak i shoqërisë “{***}” ShPK, me emrin tregtar “{***}”, shoqëri në të cilën deri në vitin 2012 ka qenë ortak në ½ me shtetasin italian C. C. dhe nga ky vit deri aktualisht është ortak i vetëm i kësaj shoqërie.

13.9 Subjekti i rivlerësimit dorëzoi dokumentacion në Komision, nga i cili rezultoi edhe vërtetimi i DRT-së Vlorë, me nr. {***} prot., datë 16.12.2020, në të cilin sqarohet se V. M. ka rezultuar si administrator: (i) i shoqërisë tregtare “{***}”, regjistruar që nga data 01.09.1993, me vendim gjykate nr. {***}; (ii) shoqërisë “{***}”, me administrator V. M., regjistruar që nga data 03.03.1999, me vendim gjykate nr. {***}; (iii) si dhe “V. M.”, person fizik me datë regjistrimi 01.01.1994. Subjekti dorëzoi, gjithashtu, vërtetimin me nr. {***} prot., datë 08.01.2021, të DRT-së Vlorë, në të cilin është sqaruar se bazuar në të dhënat e sistemit “C@TS”, për aktivitetin e shoqërisë “{***}” ShPK, është sjellë xhiro dhe fitimi për vitin 2005, si dhe për periudhën 2009-2019, pa përfshirë informacion për vitet 2006, 2007 dhe 2008. Nga kjo shkresë nuk kemi informacion për vitet, të cilat përkojnë me momentin e dhënies së huas. Subjekti dorëzoi vërtetimin, me nr. {***} prot., datë 16.10.2020, të DRT-së Vlorë, në të cilin sqarohet se për vitin 2001 shoqëria “{***}” ShPK ka pasur xhiro të deklaruar në shumë 5.750.000 lekë, tatim gjithsej 300.000 lekë, ndërsa për vitin 2002 xhiro e vetëdeklaruar rezultoi në shumë 7.750.000 lekë dhe tatim gjithsej 300.000 lekë. Gjendet i administruar në dosje edhe vërtetimi, me nr. {***} prot., datë 15.12.2020, i lëshuar nga DPSHTRr-ja¹² Vlorë, në të cilin përcaktohen mjetet motorike në pronësi të V. M. dhe shoqërisë “{***}” ShPK. Sipas kësaj shkrese rezultojnë 17 mjete në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK dhe 2 mjete në pronësi të shtetasit V. M..

13.10 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje konstatohet se shoqëritë e cituara në paragrafin më sipër kanë pasur qarkullim të lartë dhe se këto kompani kanë gjeneruar të ardhura, por nga dokumentacioni nuk del e qartë e ardhura nga biznesi për këtë subjekt

¹² Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

tatimor. Bazuar në dokumentacionin e mësipërm rezulton se nuk gjenden dokumente të bilanceve kontabël të kësaj shoqërie, ku V. M. rezulton administrator, në mënyrë të tillë që mund të verifikohet nëse shoqëria e tij ka shpërndarë dividend (fitim vjetor i aksionerëve) apo nëse ai ka tërhequr huan nga qarkullimi i shoqërisë si formë huaje që do t'i shlyhet sërish kësaj të fundit. Huadhënësi dhe subjekti i rivlerësimit kishin detyrimin ligjor dhe kushtetues që gjatë procesit të rivlerësimit të justifikonin dhe të argumentonin me dokumente shoqëruese mundësinë e dhënies së huas, por subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion financiar për të vërtetuar marrjen dhe kthimin e saj, përveç deklaratës noteriale të cituar në paragrafin më sipër. Kjo deklaratë noteriale, edhe pse e hartuar në prag të procesit të rivlerësimit, përcakton sasinë dhe kohën e marrjes së huas (e cila është mbështetur edhe nga prova të tjera në dosje, si kontrata e huas e vitit 2002 dhe deklarimi i vitit 2003), si dhe kohën e kthimit të saj, por nuk provon mundësinë financiare të V. M., për dhënien e kësaj huaje. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit dorëzoi kontratën e huas së datës 29.04.2002 të lidhur me huadhënësit V. M., kontratë të cilës i është vërtetuar nënshkrimi përpara noterës. Kjo marrëdhënie është deklaruar, gjithashtu, nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklarinimin fillestar të vitit 2003 në ILDKPKI, sipas detyrimit që rrjedh nga neni 4 i ligjit nr. 9049/2003, duke e bërë të besueshme për trupin gjykues ekzistencën e marrëdhënies së huas me z. V. M.. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe shlyerjen e kësaj huaje në DIPP-të e viteve 2004 dhe 2005, ndërsa për vitet 2006 dhe 2007 ka dhënë sqarime në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit për shlyerjen e huas së mbetur.

Si rrjedhojë e sa më sipër, dokumentacioni që ka dorëzuar subjekti i rivlerësimit për të provuar mundësinë e dhënies së huas nga personi tjetër i lidhur, si detyrim që buron nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk provoi sasinë e të ardhurave dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre, të cilat pretendohen se kanë shërbyer për dhënien hua në favor të subjektit të rivlerësimit në datën 29.04.2002, të shumave 20.000 euro dhe 10.000 USD, të ardhura këto të deklaruara si burim krijimi për investimet e kryera gjatë fazës së parë dhe fazës së dytë, për pasurinë e ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë.

13.11 Në përfundim, lidhur me investimin e kryer gjatë vitit 2007, për pasurinë “shtëpi banimi”, të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, pavarësisht se nuk u provuan sa kanë qenë realisht të ardhurat e krijuara nga V. M., për të kuptuar nëse kishte mundësi për dhënien e huas subjektit të rivlerësimit, nga kontrolli që Kolegji ushtroi në analizën financiare të kryer nga Komisioni, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë burime financiare të ligjshme për të kryer investimin për pasurinë “shtëpi banimi”, në shumën 502.700 lekë.

14. Lidhur me analizën financiare të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pretendimet si vijojnë.

i) Sa i përket të ardhurave nga aktiviteti privat i bashkëshortes, subjekti kundërshton vlerën e konsideruar si fitim nga Komisioni. Sipas subjektit të rivlerësimit në analizën financiare duhet të vendosen të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes sipas mënyrës së përlllogaritur nga audituesi ligjor. Në analizën financiare për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit, mbështetur në raportin e audituesit ligjor, pretendon se gjendet në kushtet e një balance pozitive në shumën 1.227.321 lekë.

Subjekti i rivlerësimit argumenton se është fakt i njohur botërisht se aktiviteti “noteri” nuk ka shpenzime relevante, përveç pagesës së tatimit mbi xhiron, taksës vendore, sigurimeve shoqërore, si dhe atyre për konsum energji eklektike dhe blerje materiale ndihmëse, ndaj për

këtë arsye nuk mund të pranohet konkluzioni i Komisionit, se ndërkohë që qarkullimi vjetor ka qenë në shumën 5,606,123 lekë, shpenzimet të kenë qenë në shumën 4,964,703 lekë, ndërsa fitimi 641,420 lekë.

ii) Në lidhje me investimin gjatë vitit 2008 për shtëpinë e banimit të ndodhur në lagjen “{***}” Vlorë, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht investimin e kryer në shumën 516.800 lekë, duke qenë se ky vit rezulton me diferencë negative. Sipas subjektit të rivlerësimit, bazuar edhe në shpjegimet e mësipërme për këtë vit, pretendon se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar edhe këtë investim.

14.1 Arsyetimi dhe konkluzionet e Komisionit: “[...] rezulton se nga viti 2008 e në vijim e ardhura e tatueshme paguhet mbi fitimin dhe jo mbi qarkullimin. Ky fakt duket edhe në deklaratat tatimore të plotësuara nga subjekti tregtar “I. B.”, person fizik, prej vitit 2008 e në vijim, ku vërehet se janë deklaruar të ardhurat, shpenzimet dhe fitimi. Pra, Komisioni vlerëson se në analizën financiare të kryer për periudhën 2008 - 2016 janë pasqyruar saktë dhe në mënyrë korrekte të ardhurat nga fitimi neto i realizuar prej aktivitetit të noterisë dhe se, nuk mund të merren në konsideratë pretendimet e bëra nga subjekti për të ardhura më të larta nga fitimi neto për disa vite që i përkasin kësaj periudhe. Vlen të theksohet se sistemi tatimor në Republikën e Shqipërisë bazohet në vetëdeklarimet e subjektit tregtar. Për më tepër vërehet se detyrimi tatimor, si kusht për ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave, është paguar mbi fitimin e vetëdeklaruar në periudhën përkatëse dhe jo për fitimin e pretenduar në prapësimet pas dërgimit të rezultateve të hetimit”.

14.1.1 Lidhur me pasurinë godinë 4-katëshe të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, Komisioni arriti në konkluzionin se: “i. subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri dhe burimet e krijimit të saj; ii. subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht investimin e kryer/ krijimin e kësaj pasurie.

Sa më sipër, nga vlerësimi tërësor i kësaj pasurie, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61/3 i ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra”.

14.2 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se DRT-ja Vlorë, fillimisht i ka referuar Komisionit fitimin neto për vitin 2008 për bashkëshorten e tij në shumën 642.420 lekë dhe me anë të një shkresë¹³ tjetër, DRT-ja Vlorë ka informuar përsëri Komisionin se kjo nuk është shifra e saktë. Sipas kësaj shkresë, aktiviteti i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga viti 2003 deri në vitin 2014, e cila ka qenë subjekt deklarues i tatimit mbi të ardhurat e punësimit për biznesin e vogël dhe tatimit të fitimit të thjeshtuar, ndaj llogaritja e tatimit bëhej bazuar mbi qarkullimin pa marrë në konsideratë shpenzimet. Sipas subjektit në këtë shkresë sqarohet se shkalla tatimore e tatim fitimit të thjeshtuar është 1.5% dhe pavarësisht shpenzimeve që subjekti deklaroi, tatimi llogaritet mbi të ardhurën e deklaruar, për këtë arsye llogaritja e shpenzimeve nuk ndikon për efekt të tatimit të thjeshtuar. Në datën 11.05.2010, subjekti tregtar i bashkëshortes së subjektit është regjistruar në përgjegjësinë tatimore me TVSH. Sipas subjektit të rivlerësimit, bazuar në shpjegimet e kësaj shkresë, është provuar se

¹³ Shkresë e DRT-së Vlorë, me nr. {***} prot., datë 31.12.2020.

për vitin 2008, subjekti tregtar “I. B.” ka qenë person fizik biznes i vogël, me vlerë qarkullimi vjetor të realizuar dhe deklaruar nën vlerën 8.000.000 lekë dhe sipas subjektit të rivlerësimit, referuar legjislacionit në fuqi, bashkëshortja e tij për vitin 2008 ka pasur detyrimin për të deklaruar të ardhurat e realizuara dhe jo shpenzimet për këtë vit ushtrimor. Sipas subjektit të rivlerësimit në analizën financiare duhet të vendosen të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes, sipas mënyrës së përlllogaritur nga audituesi ligjor.

14.3 Sipas raportit të audituesit ligjor, për vitin 2008, në përlllogaritjen e shpenzimeve për zhvillimin e aktivitetit noterial, audituesi është bazuar në ecurinë e numrave rep/kol të regjistrit noterial, të kryer për periudhën ushtrimore, e cila për vitin 2008 ka qenë 4266 njësi. Nga analiza e kryer prej tij, ka rezultuar se shpenzimet për aktivitetin noterial për vitin 2008 kanë qenë në shumën 2.093.434 lekë, ku përfshihen shpenzimet për blerje letre, shpenzimet për blerje regjistrash noterialë, shpenzimet për energji eklektike, shpenzimet për blerje kancelarie, shpenzimet për tatimin për biznesin e vogël, shpenzimet për taksa vendore, shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet për amortizimet, inventarin ekonomik dhe, gjithashtu, shpenzime për qiranë. Këto të fundit janë përcaktuar në analizën ekonomike nga audituesi ligjor për herë të parë në vitin 2007. Në dokumentacionin në dosje, në lidhje me vendndodhjen e zyrës së noterisë, audituesi ligjor ka shpjeguar se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit e ka ushtruar aktivitetin e saj për periudhën 25 gusht 1994 deri në 31 korrik 1995 brenda zyrave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërsa në vazhdim në objektin pronë private, përfitur nga privatizimi i banesave. Në analizën financiare të kryer nga audituesi ligjor nuk janë përfshirë shpenzime për qiranë deri në vitin 2008, ku shpenzimet e qirasë janë vendosur në shumën 60.000 lekë. Në dokumentacionin e dosjes gjendet e administruar kontrata e qirasë, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2009, e lidhur ndërmjet nënës së subjektit në cilësinë e qiradhënëses dhe bashkëshortes së tij, në cilësinë e qiramarrëses, për dhënien me qira të njësisë me sip. 20 m², në lagjen “{***}”, Vlorë, kundrejt qirasë së përcaktuar në shumën 20.000 lekë në muaj. Kjo kontratë qiraje fillon efektet nga data 01.01.2010 dhe është lidhur për një afat 5-vjeçar. Nga kjo analizë e kryer nga audituesi ligjor, të ardhurat e aktivitetit noterial për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit rezultojnë në shumën 3.441.430 lekë dhe analiza financiare për subjektin e rivlerësimit në vitin 2008 rezulton me diferencë pozitive në shumën 1.227.321 lekë. Mbi bazën e këtyre rezultateve, subjekti i rivlerësimit pretendon t’i kryhen përlllogaritjet edhe në Kolegj.

14.4 Subjekti i rivlerësimit me parashtrimet mbi rezultatet e hetimit, në Komision dorëzoi edhe shkresën nga DRT-ja Vlorë, me nr. {***} prot., datë 31.12.2020, në përmbajtjen e së cilës sqarohet se në shkresat që Komisioni dhe ILDKPKI-ja kanë dërguar, është kërkuar vlera e qarkullimit ose të ardhurat e deklaruara nga subjekti “I. B.”, pra, nuk është kërkuar një interpretim lidhur me mënyrën e llogaritjes së fitimit dhe koeficientin e normës së tatimit mbi fitimin. Më tej, në këtë shkresë sqarohet se për vitet 2008, 2009 dhe 2010, referuar ligjit nr. 9844, datë 17.12.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar””, ka qenë subjekt deklarues i të ardhurave nga punësimi për biznesin e vogël dhe të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Referuar këtyre të dhënave, sqarohet në shkresë se subjekti tatimor “I. B.”, person fizik, përfshihet në fashën e subjekteve që tatohen në bazë të të ardhurës së deklaruar pavarësisht shpenzimeve. Njësia e Qeverisjes Vendore, duke iu referuar aneksit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, ka bërë

dhe përcaktimin e taksës në vlerën 68.000 lekë, duke iu referuar deklarimeve të vetë subjektit dhe verifikimet nga zyra e taksave dhe tarifave vendore të njësisë së Qeverisjes Vendore.

14.5 Kolegji vëren se në dokumentacionin e administruar në dosje gjendet edhe shkresa nr. {***} prot., datë 13.08.2020, e DRT-së Vlorë, e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në Komision me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, sipas të cilës për vitin 2008, të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti privat kanë qenë në shumën 5.606.123 lekë dhe fitimi *neto* për këtë vit rezulton në shumën 712.689 lekë. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjendet edhe formulari i printuar nga sistemi “C@TS”, në të cilin specifikohet se tatimpaguesja I. B., person fizik, ka pasur të ardhura në shumën 5.606.123 lekë, shpenzime në shumën 4.893.434 lekë dhe fitim në shumën 712.689 lekë. Në këtë formular është përlllogaritur tatimi mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël i rezultuar në shumën 71.269 lekë. Nga të dhënat e shkresës gjejmë edhe të dhënat për pagesën e tatimit mbi të ardhurat vit pas viti.

14.6 Komisioni, për përcaktimin e fitimit për vitin 2008, është bazuar në të dhënat e shkresës nr. {***} prot., datë 06.02.2018, të DRT-së Vlorë, ku e ardhura *neto* për vitin 2008 rezulton në shumën 641.420 lekë. Tatimpaguesja "I. B. ka kryer vetëdeklarim në institucionin e tatimeve për xhiron dhe shpenzimet për vitin 2008. Bazuar në këtë vetëdeklarim është përlllogaritur dhe paguar edhe vlera e tatimit mbi fitimin. Duke qenë se shkresa e DRT-së Vlorë, me nr. {***} prot., datë 13.08.2020, është administruar në Komision më vonë se shkresa me nr. {***} prot., datë 06.02.2018, e DRT-së Vlorë, në Kolegj u krye kontrolli i analizës financiare të Komisionit, duke konsideruar si fitim *neto* për vitin 2008 të dhënat e shkresës me nr. {***} prot., datë 13.08.2020, të DRT-së Vlorë.

14.7 Nga kontrolli që iu krye analizës financiare të Komisionit për vitin 2008, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe, gjithashtu, për të përballuar investimet për diferencën negative në shumën (-) 1.501.420 lekë. Si rrjedhojë e kësaj analize, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2008, duke u gjendur kështu në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

15. Lidhur me analizën financiare të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit paraqet pretendimet si vijojnë.

i) Ai pretendon se duhet të bazohemi në rezultatin e nxjerrë nga audituesi ligjor, sipas të cilit analiza e vitit 2009 rezulton me diferencë pozitive në shumën 200.778 lekë. Sipas subjektit, në analizën e Komisionit, janë konsideruar si shpenzime familjare, shpenzimet e aktivitetit privat të bashkëshortes të pasqyruara në llogarinë bankare të biznesit. Konkretisht janë konsideruar shpenzimet për blerje biletash për udhëtime jashtë shtetit në vlerën 619.440 lekë dhe interesat e *overdraft*-it në shumën 39.608 lekë. Subjekti pretendon se këto shpenzime janë pasqyruar në deklaratën vjetore të të ardhurave dhe në biznesin e bashkëshortes, ndaj si të tilla nuk mund të përlllogariten dy herë.

ii) Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton moskonsiderimin nga Komisioni në zërin “të ardhura” të shumës prej 20.000 USD të marrë në formën e huas nga T. M., për të mos u përdorur, por të vendosur si garanci bankare. Kjo shumë nga Komisioni është vendosur vetëm në zërin e mjeteve monetare. Sipas subjektit të rivlerësimit konkluzioni i Komisionit se ai nuk

arriti të provojë se T. M. ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar dhënien e huas është i gabuar. Sipas subjektit të rivlerësimit shuma e huas nuk është prekur asnjëherë prej tij dhe kjo verifikohet edhe nga konfermat bankare. Sipas subjektit të rivlerësimit vlera e *overdraft*-it duhej të ishte pasqyruar nga Komisioni në zërin “detyrime kredie” dhe jo në zërin “mjete monetare”, në fund të vitit ushtrimor.

iii) Në lidhje me dy depozitat bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe NBG Bank të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tyre, për arsye se nuk kanë deklaruar shtesa të likuiditeteve *cash* për periudhën e deklarimit 2003-2008. Sipas subjektit të rivlerësimit ky konkluzion është i gabuar sepse bazuar në dokumentacionin bankar, depozitat nuk janë krijuar në vitin 2009, por janë riinvestim disavjeçar, duke filluar nga vitit 2002 dhe në vazhdim në Intesa Sanpaolo Bank, ndërsa në NBG Bank duke filluar nga viti 2005. Sipas subjektit burimi i krijimit të tyre është nga aktiviteti noterial dhe mosdeklarimi i tyre në vitet 2003-2008, si llogari rrjedhëse apo depozita bankare, nuk ka pasur për qëllim fshehjen e tyre përderisa janë lehtësisht të verifikueshme, por ka ndodhur për shkak se dinamika e vlerave të tyre ka qenë shumë e ulët dhe për faktin se janë përfshirë në vlerat e qarkullimit të deklaruar nga subjekti “I. B.”, person fizik.

15.1 Lidhur me sa më sipër, Komisioni ka arsyetuar dhe konkluduar se *duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur nuk kanë deklaruar shtesa të likuiditeteve cash për periudhën e deklarimit 2003 – 2008, të cilat të mundësonin krijimin e dy depozitave në vitin 2009, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm për burimin e krijimit të këtyre dy depozitave dhe, si rrjedhim, nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar krijimin e tyre.*

Lidhur me pretendimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit për rezultatet e analizës financiare për vitet 2009, 2010, 2011, 2013 dhe 2014, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e depozituara, Komisioni vlerësoi: (a) të ardhurat nga fitimi neto nga ushtrimi i aktivitetit të noterisë për këto vite janë pasqyruar në mënyrë korrekte në analizën financiare bazuar në informacionin e dërguar nga DRT-ja Vlorë, bazuar në të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Në kushtet kur sistemi tatimor në Republikën e Shqipërisë bazohet në vetëdeklarimet e subjektit tregtar dhe se detyrimi tatimor, si kusht për ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave është paguar mbi fitimin e vetëdeklaruar nga ky subjekt tregtar, trupi gjykues vlerëson se nuk mund të merren në konsideratë pretendimet e subjektit për realizimin e fitimeve me vlerë më të madhe nga ai i vetëdeklaruar në pasqyrat financiare, pasi ato janë të karakterit deklarativ dhe të paprovuara me dokumentacion justifikues ligjor.

15.2 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, ndodhen gjendjet e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij. Nga verifikimi, nëpërmjet NjShL-së në Kolegj, i gjendjeve të llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, vërehet se është përdorur shpesh llogaria bankare në funksion të aktivitetit privat të bashkëshortes së subjektit, për pagesa shpenzimesh familjare. Subjekti ka argumentuar në ankim se aktiviteti i bashkëshortes është një biznes familjar, duke pretenduar që në analizën financiare të vitit 2009 të mos përfshihen shpenzimet e udhëtimit, duke qenë se këto shpenzime janë paguar nga llogaria bankare e aktivitetit të bashkëshortes dhe se janë përballuar nga të ardhurat e aktivitetit. Në llogarinë personale pranë Intesa Sanpaolo Bank, në monedhën euro të I. B., gjatë vitit 2009, gjenden veprime si transferime dhe kalime të familjarëve, pagesa interesash *overdraft*-i dhe

pagesa biletash udhëtimi. Totali i paguar për bileta udhëtimi gjatë vitit 2009 rezulton në shumën 951.38 euro.

15.3 Në dokumentacionin e administruar në dosje, bashkëlidhur shkresës, me nr. {***} prot., 06.02.2018, të DRT-së Vlorë, gjenden edhe pasqyrat financiare për aktivitetin noterial të I. B. për periudhën 01.01.2009 - 31.12.2009. Në këto pasqyra financiare rezulton se fitimi *neto* për t'u shpërndarë është në shumën 1.035.000 lekë. Në deklaratën analitike për tatimin mbi të ardhurat bashkëngjitur shkresës cituar më sipër, shpenzimet janë vendosur në një total prej 1.850.000 lekësh. Zëri “shpenzime” nuk është detajuar në asnjë prej rubrikave të pasqyrave financiare, në mënyrë të tillë që të kuptohet nëse janë përfshirë në këtë zë edhe pagesat për udhëtime personale në shpenzimet e aktivitetit noterial. Si shpenzime për këtë aktivitet duhet të përfshihen vetëm ato, të cilat janë kryer për të lehtësuar apo për të siguruar vijueshmërinë e aktivitetit noterial. Bazuar në nenin 12¹⁴ të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit në ushtrimin e aktivitetit të noterisë si person fizik, i regjistruar pranë organeve tatimore, është personi përgjegjës për pasqyrat financiare të miratuara prej tij dhe të depozituara pranë organeve kompetente, duke përfshirë në këto pasqyra financiare dokumentet e parashikuara sipas këtij neni. Sipas kësaj dispozite gjendja e llogarive (pasqyra e rrjedhjes së parasë) të aktivitetit tregtar përfshihet në pasqyrat financiare vjetore të cilat dorëzohen në organet tatimore. Duke qenë se në këto pasqyra financiare përfshihen të ardhurat dhe shpenzimet e aktivitetit noterial, shpenzimet për udhëtime personale dhe nevoja familjare nuk mund të përfshihen në kategorinë e shpenzimeve që kryhen në funksion të këtij aktiviteti, si rrjedhojë trupi gjykues vlerësoi të drejtë qëndrimin e Komisionit për konsiderimin e shpenzimeve për biletat e udhëtimit jashtë vendit si shpenzim i familjes së subjektit të rivlerësimit. Ky qëndrim i Kolegjit do të mbahet në konsideratë dhe në vitet e tjera, për të cilat subjekti i rivlerësimit për shpenzimet e udhëtimit ka paraqitur pretendime që t'i përfshihen në kategorinë e shpenzimeve të aktivitetit noterial.

15.4 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi përlllogaritjen e gabuar të interesave të *overdraft*-it duke qenë se këto interesa janë mbuluar nga aktiviteti noterial, bazuar në dokumentacionin në dosje ku gjendet praktika e këtij *overdraft*-i, Kolegjit i rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, si individ, në datën 25.08.2009 ka lidhur “Kontratë kredie me kufi” (nuk është lidhur kontrata para noterit), në Intesa Sanpaolo Bank, për vlerë të aprovuar në shumën 12.700 euro, me qëllim *shlyerje këst blerje apartamenti*. Nga verifikimi i gjendjes së llogarisë personale, në monedhën euro, me nr. {***}, të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në datën 26.08.2009 është përdorur *overdraft*-i në shumën 12.000 euro, i cili është transferuar në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin *prenotim blerje apartamenti*. Ky *overdraft* ka shërbyer për të likuiduar pagesën e njërit prej kësteve të apartamentit të banimit të ndodhur në Tiranë dhe nuk ka shërbyer për të mbuluar shpenzime

¹⁴ Neni 12 “Përbërësit e pasqyrave financiare” parashikon: “Pasqyrat financiare vjetore, përveç atyre që parashikohen në mënyrë të specifikuar nga standardet kontabël kombëtare, duhet të përmbajnë këto dokumente:

a) bilancin kontabël;

b) pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve;

c) pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta;

ç) pasqyrën e rrjedhjes së parasë;

d) anekset e pasqyrave financiare, që përmbajnë një paraqitje të metodave kontabël, si dhe materialin tjetër shpjegues”.

apo investime që lidhen me aktivitetin noterial. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerësoi të drejtë qëndrimin e Komisionit që mos përfshihet si një shpenzim i aktivitetit noterial të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Në dokumentacionin financiar të aktivitetit noterial nuk gjenden të dhëna që të vërtetojnë se interesat e *overdraft*-it janë përlogaritur si të likuiduara gjatë vitit 2009 nga aktiviteti noterial. Në lidhje me mënyrën e pasqyrit në analizën financiare të gjendjes së *overdraft*-it, gjendet i drejtë pretendimi i subjektit të rivlerësimit se përdorimi i *overdraft*-it duhet të paraqitet në zërin e detyrimeve. Në gjendjen përfundimtare të llogarisë bankare në Intesa Sanpaolo Bank, në të cilën është disbursuar *overdraft*-i, trupi gjykues vlerësoi se do të përlogaritet vetëm gjendja e akumuluar e interesave, pa vlerën e përdorimit të këtij *overdraft*-i, vlerë e cila do të pasqyrohet në zërin detyrime.

15.5 Bashkëlidhur kontratës së kredisë me kufi, cituar në paragrafin më sipër, gjendet edhe “Marrëveshja siguroese” e datës 25.08.2009 e lidhur ndërmjet I. B. si individ dhe Intesa Sanpaolo Bank, në të cilën parashikohet se barrëdhënësi, në këtë rast I. B., krijon në favor të bankës një depozitë me afat me qëllim që të sigurojë përmbushjen me pagimin e plotë të detyrimit prej 12.700 eurosh. Me qëllim krijimin e kësaj depozite, bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontratën e huas, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.08.2009, me huadhënëse znj. T. M. dhe huamarrëse znj. I. H. B., në të cilën përcaktohet se znj. T. M. në cilësinë e palës huadhënëse i jep hua znj. I. B. shumën prej 20.000 USD. Në këtë kontratë parashikohet se huamarrësi (I. B.) shumën e përfituar nga kjo huamarrje do ta depozitojë në Intesa Sanpaolo Bank, dega Vlorë, në formën e një depozite me afat 1-vjeçar. Interesat e depozitës, sipas kontratës së huas, do të përfitohen nga huadhënësi. Pra, kjo hua do të përdoret si një garanci bankare për një periudhë 1-vjeçare dhe pas përfundimit do t’i kthehet huadhënëses së bashku me interesat bankare që do të përfitojë.

15.6 Lidhur me të ardhurat e personit tjetër të lidhur (huadhënëses T. M.), Komisioni konstatoi se dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit nuk justifikon ligjshmërinë e të ardhurave që pretendohet se kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës prej 20.000 USD nga huadhënësi, si rrjedhojë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet e tij përfundimtare dhe depozitim të provave të reja të mundshme në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion, nëpërmjet të cilit pretendon të provojë ligjshmërinë e burimeve të krijimit të të ardhurave, deklaruar si të marra hua nga znj. T. M.. Në dokumentacionin që ka dorëzuar subjekti i rivlerësimit bashkë me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, Komisioni ka konstatuar se nuk rezulton që subjekti tregtar “{***}” ShPK të ketë shpërndarë dividend për periudhën para dhënies së kësaj huaje dhe se të ardhurat¹⁵ nga paga të znj. T. M. nga punësimi në shoqërinë “{***}” SHPK, për periudhën 2000 – 2009, janë në vlera të tilla që nuk mund të mbulojnë as krijimin e gjysmës së shumës së dhënë hua, pa llogaritur investime dhe shpenzime të mundshme për këtë periudhë. Si rrjedhojë, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15.7 Kolegji vëren se nga verifikimi i llogarisë personale në monedhën USD, me nr. {***}, në Intesa Sanpaolo Bank, të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit rezulton e depozituar shuma

¹⁵ Në referim të informacionit të DRSSh-së Vlorë (vërtetimi nr. {***} prot., datë 08.01.2020), depozituar si provë nga subjekti, në të cilin referohen të dhëna të punësimit të T. M. në shoqërinë “{***}” ShPK e, konkretisht, pagat mbi të cilën janë paguar kontributet për periudhën vitit 2000 e në vijim.

20.000 USD, që është përdorur si garanci për shlyerjen e kredisë. Në datën 24.08.2017¹⁶ është transferuar shuma prej 21.556,07 USD, në llogari të T. M. me përshkrimin *mbyllje detyrimi, kthim huaje, sipas kontratës, datë 13.08.2009, me nr. {***} rep., nr. {***} kol.* Në interpretim të dispozitave përkatëse të Kodit Civil mbi kontratën e huas¹⁷, marrëdhënia e krijuar mes znj. T. M. dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, si pasojë e depozitimit nga znj. I. B., në llogarinë bankare të saj në Intesa Sanpaolo Bank, të shumës prej 20.000 USD të marrë hua T. M., përmbush kërkesat e nenit 1050 të Kodit Civil, për ta vlerësuar këtë marrëdhënie në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar si një marrëdhënie huaje, me objekt shumë prej 20.000 dollarësh, e cila, referuar kontratës së huas së datës 13.08.2009, i është dhënë subjektit të rivlerësimit me qëllim garantimin e kredisë së marrë nga Intesa Sanpaolo Bank dhe me afat deri në shlyerjen e saj.

15.8 Nga situata faktike si më sipër, bazuar në jurisprudencën¹⁸ e Kolegjit rezulton se nga analizimi i transaksioneve të kryera në llogarinë e garancisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, si më sipër përmendur, vërehet se nga totali i vlerës së dhënë hua nga znj. T. M. bashkëshortes së subjektit, kjo e fundit më 24.08.2017 ka transferuar shumë prej 21.556,07 USD (hua+interesa), në llogari të T. M. me përshkrimin *mbyllje detyrimi, kthim huaje sipas kontratës, datë 13.08.2009, me nr. {***} rep., nr. {***} kol.* Nga këto transaksione vërehet se kjo shumë, e cila është dhënë hua nga znj. T. M., ka shërbyer vetëm për qëllimin e garantimit të kredisë, pasi nuk rezulton të jetë futur në qarkullim nga ana e subjektit të rivlerësimit për t'u përdorur, as për krijim pasuri, as për mbulim shpenzimesh të tjera të ekonomisë së tij familjare dhe as rezulton të jetë deklaruar si burim për qëllime të kësaj natyre. Në kushtet kur kthimi i kësaj huaje huadhënëses, rezulton të jetë kryer nga huamarrësja bashkëshortja e subjektit nga paratë e bllokuara në depozitën e garancisë, trupi gjykues vlerësoi se kjo hua nuk ka sjellë asnjë efekt në analizën e kryer në kuadër të kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, përveçse sigurimit të kredisë së marrë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, si rrjedhojë analizimi i mundësisë së dhënies së huas nga znj. T. M. do të ishte në tejkallim të objektit dhe kufizimeve që përcakton ligji në funksion të rivlerësimit kalimtar.

15.9 Lidhur me depozitat e krijuara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ky i fundit sqaron se nga fondet e lira në këtë llogari, në datën 15.02.2007 është çelur depozitë e re me interes, në shumë 214.158 lekë, me afat 6-mujor dhe e rinovueshme çdo gjashtë muaj. Pra, çdo gjashtë muaj kësaj depozite i është shtuar gjendja e lirë e llogarisë, duke krijuar çdo gjashtë muaj një depozitë e re. Është e provuar nga aktet e administruara në dosje se depozita nuk është krijuar në datën 17.08.2009. Në ekstraktin bankar të lëshuar nga NBG Bank, të administruar nga Komisioni, konstatohet se në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në datën 24.05.2005 është çelur llogaria rrjedhëse në monedhën lekë, vlerat e të cilës janë investuar dhe riinvestuar në vlerë depozite, e cila është rritur nga interesat që ka gjeneruar, si dhe duke i bashkuar gjendjen që ka pasur llogaria rrjedhëse në lekë.

¹⁶ Kjo hua është kthyer në vitin 2017, edhe pse në kontratën e huas ishte parashikuar një afat 1-vjeçar, deri në shlyerjen e kredisë (overdraft-it).

¹⁷ Neni 1050 i Kodit Civil parashikon: "Me kontratën e huas njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t'i kthejë huadhënësit atë të holla, ose atë sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit".

¹⁸ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 1/2022 (JR), datë 27.01.2022 (A. Kalaja).

15.10 Kolegji vëren se nga verifikimi i llogarisë me nr. {***} pranë Intesa Sanpaolo Bank rezulton se llogaria është e vjetër, e cila është mbartur që nga data 01.01.1998. Kjo llogari bankare akumulon balancë nga veprime të ndryshme noteriale të kryera në favor të aktivitetit noterial. Në datën 15.08.2007, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit e ka kaluar në depozitë 6-mujore balancën e krijuar dhe për çdo 6 mujor në vazhdim ka rritur depozitën me balancën e krijuar nga kjo llogari. Llogaria në NBG Bank, me nr. {***}, është një llogari e krijuar në datën 20.04.2005, e cila është furnizuar nga të ardhurat e aktivitetit noterial dhe balancat e krijuara janë depozituar në depozita me afat të shkurtër. Si rrjedhojë e kësaj situate, në Kolegji, gjendja e këtyre depozitave është përfshirë në gjendjen e llogarive bankare në fund të vitit. Si rrjedhojë e sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se depozitat janë riinvestim disavjeçar duke filluar nga vitit 2002 dhe në vazhdim dhe mosdeklarimi i tyre në vitet 2003-2008 si llogari rrjedhëse apo depozita bankare nuk ka pasur për qëllim fshehjen e tyre përderisa janë lehtësisht të verifikueshëm.

15.11 Bazuar në qëndrimet e mësipërme, nga kontrolli që ushtroi Kolegji në analizën financiare të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme në vitin 2009, për të krijuar pasurinë, të krijonin kursime dhe, gjithashtu, të përballonin shpenzimet, për diferencën negative në shumën (-) 498.182 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

16. Lidhur me analizën financiare të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për rezultat financiar negativ për vitin 2010 në shumën (-) 3.935.063 lekë dhe për analizën e fragmentuar deri në datën 02.06.2010, që Komisionit i rezultoi në diferencën negative në shumën (-) 1.759.308 lekë, duke paraqitur pretendimet si vijojnë.

i) Sipas subjektit të rivlerësimit, analiza duhet të ishte zhvilluar sipas mënyrës së përlllogaritur nga audituesi ligjor, duke rezultuar me diferencë pozitive për gjithë vitin 2010 në shumën 964.494 lekë dhe për periudhën e fragmentuar 01.01.2010-02.06.2010, me diferencë pozitive në shumën 194.084 lekë.

ii) Subjekti i rivlerësimit pretendon se nga Komisioni nuk është llogaritur në mënyrë të saktë tarifa e shkollimit të vajzës së tij në Universitetin “{***}”, në Itali, edhe pse subjekti ka paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm për të vërtetuar këto tarifa. Sipas subjektit të rivlerësimit, bazuar në dokumentacionin që i ka vënë në dispozicion Komisionit, vërtetohet akordimi i bursës dhe pagesat e tarifave të studimit për të bijën.

iii) Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka gabuar që nuk e ka përfshirë si të ardhur të ligjshme shumën prej 10.000 eurosh të marrë hua nga miku i tij A. D., me arsyetimin që dokumentacioni nuk është në formën e kërkuar nga ligji. Sipas subjektit ky përfundim është i gabuar, sepse të gjitha dokumentet e paraqitura krijojnë bindjen se A.D. kishte mundësi financiare për të dhënë huan në datën 29.05.2010 në favor të subjektit të rivlerësimit.

16.1 Konkluzionet e Komisionit për analizën e vitit 2010: *“Nga verifikimi dhe analizimi i dokumenteve të dërguara si prova të reja nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, pasi, megjithëse dokumentacioni i depozituar referon disa të dhëna financiare të personit tjetër të lidhur, ai nuk është në formën e kërkuar nga ligji dhe as nuk përmbush kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

[...] Si konkluzion, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti ka kryer deklarin të pamjaftueshëm dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar kryerjen e pagesave në favor të ALUIZNI-t Vlorë në datën 2 qershor të vitit 2010, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 61/3 i ligjit nr. 84/2016”.

16.2 Kolegji vëren se lidhur me përgjigjet që ka dhënë subjekti i rivlerësimi në pyetësonin standard për shkollimin e vajzës jashtë Shqipërisë, Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2 i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me tarifat e paguara dhe dokumentacionin për përfitimet përkatëse të bursës nga vajza, për të cilën subjekti ka sqaruar se vajza e tij A. H. ka kryer studimet në Milano, Itali, në universitetin “{***}”, studime të cilat kanë zgjatur pesë vjet prej vitit 2009 deri në vitin 2014, më pas në qershor të vitit 2015 është diplomuar. Bashkëlidhur këtij pyetësoni subjekti i rivlerësimi ka paraqitur dokumentacion në gjuhën italiane me titull “Deklaratë zëvendësuese e certifikimit”, nga i cili rezulton se, sipas këtij dokumenti, janë përcaktuar tarifat e shkollimit, si dhe kontributi i universitetit në formë burse për secilin vit, nga 2009-2015, të cilat janë pasqyruar e përlloritur në relacionin ekonomik.

Sipas informacionit të këtij dokumenti, për vitin 2010 është paguar shuma 3.044,48 euro dhe nga universiteti është plotësuar në formën e bursës shuma 1.171,76 euro. Të dy këto shuma plotësojnë vlerën 4.216,24 euro që është pagesa e shkollimit për vitin 2010.

16.3 Subjekti i rivlerësimi ka argumentuar në ankim se për vitin 2010 tarifa e pagesës së kështit të parë të detyrimeve shkollore ishte në vlerën 4.216,24 euro dhe për të kryer këtë pagesë dhe për të përballuar shpenzimet e jetesës, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimi ka kaluar në llogari të vajzës së tij në “Banca Popolare di Sondrio”, në Milano, shumë prej 10.000 eurosh. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se në llogarinë bankare në monedhën euro, me numër {***}, pranë Intesa Sanpaolo Bank, të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimi, më datë 10.09.2010 është kryer veprimi transfertë e llojit “overseas”, të shumës prej 10.000 eurosh, me përfituese A. H., në Itali. Komisioni këtë shumë të transferuar nga bashkëshortja e subjektit e ka konsideruar të gjithën si shpenzim për shkollimin e vajzës në vitin 2010. Subjekti ka paraqitur edhe një dokument, për të cilin pretendon se ka të dhëna të gjendjeve të llogarisë bankare të vajzës së tij, në Itali, për vitin 2010. Të dhënat e këtij dokumenti, me titull “Movimentazione Conti”, janë përfshirë edhe në analizën e kryer nga audituesi ligjor. Në përmbajtje të tij rezulton se në datën 13.09.2010 është kredituar gjendja e llogarisë në shumë 9.974 euro (sipas shpjegimeve të subjektit është shuma e derdhur nga bashkëshortja e subjektit në llogarinë e vajzës, me nr. {***}, në Banca Popolare di Sondrio). Gjithashtu, vërehen tri kreditime të tjera në shumat 2.060 euro në datën 26.01.2010; 500 euro në datën 02.07.2010; dhe 2060 euro në datën 18.10.2010, për të cilat subjekti i rivlerësimi sqaron se janë kreditime nga universiteti “{***}”. Nga ky dokument/ekstrakt bankar, deri në datën 17.12.2010, nga veprimet e paraqitura në të, duket se ka pasur gjendje në shumë 6.176,89 euro.

16.4 Pikërisht, për shumë 6.176,89 euro, e cila është gjendje në llogari, subjekti i rivlerësimi pretendon se është tepricë, pasi nuk është shpenzuar e gjithë shuma (10.000 euro) e hedhur në llogarinë e vajzës nga bashkëshortja e tij. Ai parashtron në ankim se shpenzimet shkollore për vajzën, në Itali, për vitin 2010, janë në vlerën 3.044,48 euro dhe jo siç e ka vlerësuar tërësisht gabim Komisioni, në vlerën 1.810.116 lekë, duke i përfshirë të gjithë shumë 10.000 euro si të shpenzuar. Në kontekst të sa më sipër, Kolegji vlerëson se përmbajtja e dokumentit duhet t'i nënshtrohet përfshirjes në analizën e vitit 2010, si rrjedhojë shuma prej 10.000 eurosh e derdhur

nga bashkëshortja në llogarinë e vajzës së saj, në Itali, nuk u konsiderua si shpenzim i vitit 2010. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit i ushtruar në Kolegj, shpenzimet e arsimimit të vajzës janë vendosur në shumën 3.044,48 euro, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, shumë e cila përkon me tarifën e shkollimit pas zbritjes së bursës.

16.5 Lidhur me huan e marrë nga z. A. D., subjekti parashtron në ankim se i duhej bashkë me personin tjetër të lidhur të siguronin dokumente të vjetra, deri para 10 vitesh, të cilat nuk janë mbajtur nga autoritet doganore dhe tatimore, si dhe ishte e pamundur të siguronin dokumente nga Italia në një periudhë kohore pandemie kur pajisja me vulën *apostile* të dokumentacionit ishte e pamundur. Sipas subjektit të rivlerësimit, dokumentacioni i paraqitur ka qenë i mjaftueshëm dhe nuk duhet të ishte vlerësuar nga Komisioni, mungesa në formën e kërkuar nga ligji.

16.6 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë huaje, datë 29.05.2010, e legalizuar, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., nga Notere A. M., Vlorë, e lidhur ndërmjet huadhënësit: A. D. dhe huamarrësit Enrik Haxhiraj dhe I. B. (H.), në shumën 10.000(dhjetëmijë) euro me afat 1(një) vjeçar dhe pa interes, me qëllim përdorimin e kësaj huaje si likuidim të kështit vijues lidhur me porosinë për blerje të pasurisë “apartament”, të ndodhur në Tiranë, me palë shitëse e ardhshme: shoqëria “{***}” ShPK, me seli në Vlorë dhe palë blerëse Enrik Haxhiraj dhe I. B., në bazë të aktit noterial: “Aktmarrëveshje për shitblerje pasurie apartament në ndërtim” legalizuar në datën 13.07.2009, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., nga Notere A. M., Vlorë”. Në këtë deklaratë subjekti ka deklaruar se detyrimi është shlyer tërësisht deri në datën 07.01.2014 nga të ardhurat e aktivitetit noterial, nëpërmjet veprimeve bankare.

Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *kontratë huaje datë 29.05.2010 me afat njëvjeçar, legalizuar, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., nga Notere A. M. (Dhoma e Noterisë Vlorë), me palë huadhënëse z. A.D. në shumën 10.000 euro.*

Në vitin 2011 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se i ka shlyer 3.000 euro A. D.. Në vitin 2012 ka deklaruar se i ka shlyer 6.000 euro huadhënësit, ndërsa në vitin 2013 ka deklaruar se i ka shlyer edhe shumën e mbetur prej 1.000 eurosh huadhënësit A. D. dhe se detyrimi i mbetur është 0 (zero).

16.7 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se me kontratën e huas¹⁹ së datës 29.05.2010 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, si person fizik – notere, kanë marrë nga shtetasi A. D. huan në shumën 10.000 euro. Në kontratën e huas përcaktohet se vlera e saj do të përdoret nga huamarrësit për likuidimin e një kësti për blerjen e apartamentit në Tiranë, porositur për blerje nëpërmjet shoqërisë “{***}” ShPK. Gjithashtu, në kontratë përcaktohet se, në përfundim të afatit të huas, huamarrësi do t’i likuidojë huadhënësit gjithë shumën e huazuar prej tij (10.000 euro), si dhe një interes në shumën 2% në vit. Subjekti i rivlerësimit e ka shlyer huan në vitet sipas sqarimeve në paragrafin më sipër. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision deklaratën noteriale, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.01.2014, në të cilën deklaruesit A. D., I. B. (si individ dhe jo si person fizik) dhe Enrik Haxhiraj deklarojnë se është realizuar kthimi i huas nga huamarrësit në llogarinë bankare të huadhënësit A. D., si dhe në formën *cash*, ndaj palët nuk kanë më asnjë detyrim ndaj njërit-tjetrit.

¹⁹ *Kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.05.2010.*

16.8 Bazuar në pikën 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. A. D. bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës së dhënë hua subjektit të rivlerësimit. Nga dokumentacioni që subjekti i rivlerësimit dorëzoi për të provuar mundësinë e dhënies së huas në favor të tij, Komisioni konstatoi se personi tjetër i lidhur, A. D., nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar dhënien e huas në datën 29.05.2010, në shumën 10.000 euro. Si rrjedhojë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegimet e tij përfundimtare dhe depozitimim e provave të reja të mundshme në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit bashkë me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit ka dorëzuar në Komision disa dokumente për të provuar mundësinë e personit tjetër të lidhur për të dhënë huan prej 10.000 eurosh, prej të cilave deklaratën doganore të A. D. për zhdoganimin e pjesëve të këmbimit për automjete dhe artikuj elektro-shtëpiake, si dhe pasqyrën e llogarisë bankare në Intesa Sanpaolo Bank, në Itali, për periudhën 01.10.2010 - 31.11.2010, me gjendje në datën 31.10.2010 në shumën 33.293 euro. Kontratë shitblerje apartamenti në Vlorë e datës 18.08.2010, blerë nga z. A. D. në shumën 29.600 euro. Vërtetim page të lëshuar më datë 24.08.2020 nga shoqëria “{***}” ShPK, nga i cili rezulton se z. A. D. ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie, duke bashkëlidhur disa tabela që pasqyrojnë të ardhurat *bruto* dhe *neto* për periudhën 23.08.2008 - 19.07.2018, të pashoqëruara me pagesën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore për të ardhurat e përfituara.

16.9 Nga sa rezultoi më sipër, Kolegji vëren se me dokumentacionin që disponohet nuk mund të kryhet një analizë e mirëfilltë financiare, duke përlllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së A. D., për të parë mundësinë e krijimit të shumës 10.000 euro të dhënë hua subjektit të rivlerësimit. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, megjithëse kishte barrën e provës, nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, pasi, megjithëse dokumentacioni i depozituar referon disa të dhëna financiare të personit tjetër të lidhur, ai nuk përmbush kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

16.10 Në përfundim të sa më sipër, duke moskonsideruar si të ardhur të ligjshme dhënien e huas nga A. D. për të kryer pagesën e apartamentit, gjithashtu, duke përlllogaritur si shpenzim nga transfertat prej 10.000²⁰ eurosh të bashkëshortes së subjektit në llogarinë e së bijës në Itali, vetëm shumën 3.044,48 euro, meqenëse shuma 6.176,89 euro është gjendje në llogarinë e bashkëshortes, Kolegjit nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit i rezultoi se për vitin 2010 subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të blerë pasuritë dhe përballuar shpenzimet për diferencën negative në shumën (-) 2.461.435 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 17. *Lidhur me analizën financiare të vitit 2011***, subjekti i rivlerësimit parashtroi në ankim se Komisioni ka gabuar në konkluzionin e tij se ky vit paraqet balancë negative në shumën (-) 706.992 lekë, duke qenë se për këtë vit, sipas analizës së kryer nga audituesi ligjor, diferenca është pozitive në shumën 30.625 lekë, duke paraqitur pretendimet si vijojnë.

²⁰ Shuma prej 10.000 eurosh është transferuar në llogari më datë 13.09.2010, ndërsa tarifa e universitetit për vitin 2010, sipas dokumentit “Deklaratë zëvendësuese e certifikimit është kryer më datë 14.09.2010, si rrjedhojë shuma prej 10.000 eurosh është konsideruar shpenzimi në total i shkollimit, duke i përfshirë brenda edhe pagesën e vitit 2010 prej 3.044,48 eurosh, ndryshe nga Komisioni, i cili transfertës 10.000 euro i ka shtuar edhe tarifën e vitit 2010 prej 3.044,48 eurosh.

i) Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka llogaritur fitimin *neto* të aktivitetit të noterisë duke mos marrë parasysh taksën fikse për biznesin e vogël, e cila i zbritet tatimit të thjeshtuar të fitimit të llogaritur.

ii) Subjektit i rivlerësimit pretendon se Komisioni e ka ngarkuar dy herë me shpenzime duke përlllogaritur shpenzimet e udhëtimit në shumën prej 180.609 lekësh dhe interesa të *overdraft*-it pranë Intesa Sanpaolo Bank, në shumën prej 611.442 lekësh. Këto, sipas subjektit, janë pasqyruar si shpenzime në aktivitetin e noterisë së bashkëshortes. Nga analiza financiare e hartuar nga audituesi ligjor, subjekti i rivlerësimit pretendon se viti 2011 ka diferencë pozitive në shumën 30.625 lekë.

17.1 Kolegji vëren se nga dokumentacioni financiar i administruar për aktivitetin privat të bashkëshortes së subjektit, gjenden pasqyrat financiare për vitin 2012, në të cilat është mbartur edhe informacioni kontabël për vitin paraardhës që është viti 2011. Nga ky informacion rezulton se për vitin 2011 të ardhurat nga aktiviteti noterial kanë qenë në shumën 4.155.386 lekë, shpenzimet kanë qenë në shumën 2.179.136 lekë dhe fitimi pas pagesës së tatimit për vitin 2011, pagesa e të cilit përfundon në mars të vitit 2012, ka rezultuar në shumën 1.778.625 lekë, siç ia ka përlllogaritur Komisioni. Subjekti i rivlerësimit argumenton në ankim se fitimi ka qenë në vlerën 1.861.625 lekë, pasi një pjesë e tatimit të rezultuar nga bilanci i vitit 2011 paguhet në mars të vitit 2012, ndaj pretendon të mos i llogaritet në vitin 2011. Edhe nga të dhënat e sistemit “C@TS” për vitin 2011 rezulton se të ardhurat për këtë vit kanë qenë në shumën 4.155.386 lekë. Fitimi para pagimit të tatimit (tatimi paguhet në mars të vitit 2012) ka qenë në shumën 1.976.250 lekë dhe fitimi pas pagesës së tatimit në mars të vitit 2012 rezulton në shumën 1.778.625 lekë.

17.2 Në vlerësim të këtij pretendimi të subjektit, Kolegji sjell në vëmendje përcaktimet e nenit 29 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”*. Si rrjedhojë e sa më sipër, për ta lidhur me situatën konkrete tatimore të bashkëshortes së subjektit, tatimi i detyrueshëm për t’u paguar, i cili ka rezultuar në deklaratën e të ardhurave të dorëzuar në mars të vitit 2012, ka qenë në shumën 114.625 lekë, detyrim i cili është shlyer po në mars të vitit 2012, për këtë arsye, pavarësisht se është tatim i fitimit për të ardhurat e vitit 2011, nuk përfshihet në analizën financiare si shpenzim i vitit 2011. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se fitimi nga aktiviteti privat i bashkëshortes, për vitin 2011 duhet të përlllogaritet në shumën 1.861.625 lekë, si rrjedhojë e gjeti të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

17.3 Lidhur me pretendimin për shpenzimet e udhëtimit, të cilat janë tërhequr nga llogaria e bashkëshortes si person fizik, trupi gjykues mban të njëjtin qëndrim si në paragrafin 18.3 më sipër, sipas të cilit, si shpenzime për këtë aktivitet duhet të përfshihen vetëm ato të cilat janë kryer për të lehtësuar apo për të siguruar vijueshmërinë e aktivitetit noterial dhe që janë kryer në interes të drejtpërdrejtë të veprimtarisë ekonomike. Shpenzimet për udhëtime dhe nevoja familjare nuk mund të përfshihen në kategorinë e shpenzimeve që kryhen në funksion të

aktivitetit noterial. Në kushtet kur nuk gjendet informacion i mjaftueshëm i detajuar në pasqyrat financiare, për të kuptuar nëse janë përfshirë apo jo si shpenzim në bilancin e aktivitetit noterial, si dhe duke pasur në konsideratë që në këtë proces, sipas parashikimeve të nenit Ç, pika 5 të Aneksit të Kushtetutës barrën e provës e ka subjekti i rivlerësimit, vlera e shpenzuar për biletat e udhëtimit është përlllogaritur si shpenzim i familjes së subjektit të rivlerësimit.

17.4 Nga kontrolli i ushtruar në Kolegj për analizën financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për vitin 2011, për të përballuar krijimin e pasurive dhe shpenzimet e vitit për diferencën negative në shumën (-) 623,994 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

18. **Lidhur me analizën financiare të vitit 2013**, subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit për diferencën negative në shumën (-) 1.164.816 lekë është i gabuar. Sipas subjektit të rivlerësimit në analizën e Komisionit nuk është paraqitur për vitin 2013 zëri “Detyrime” për parapagimin në shumën 3.927.812 lekë për pasurinë “njësi”, me sipërfaqe 23,8 m², e ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, në emër të subjektit tregtar “I. B.”, paraqiti pretendimet si vijojnë.

i) Subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën e Komisionit janë vendosur shpenzimet e udhëtimeve, shpenzimet për interesa kredie dhe *overdraft*-i, si shpenzime që i përkasin familjes, kur në fakt këto janë deklaruar si shpenzime të aktivitetit noterial.

ii) Sipas subjektit të rivlerësimit vlera e pasurisë “njësi”, me sipërfaqe 23,8 m², në qytetin e Vlorës, është paraqitur në pasqyrën financiare të vitit 2013 në grupin “Aktive”, kreditë dhe *overdraft*-i janë pasqyruar në grupin “Pasive”. Pasqyrimi i shpenzimeve të mësipërme në analizën financiare të subjektit dhe personave të tjerë të lidhur, nga ekspertët e Komisionit është një veprim i dubluar.

Subjekti i rivlerësimit pretendon se është tërësisht i gabuar pretendimi i Komisionit se është paguar e gjithë shuma prej 9.000.000 lekësh, pasi është provuar me konfermat bankare se në datën 27.09.2013 është kaluar shuma prej 4.458.281 lekësh, në llogarinë bankare të shitëseve E. M. dhe M. M.. Sipas subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, rezulton se subjekti tregtar “I. B.”, Person Fizik, në rubrikat “Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë”, në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016 dhe në deklaratën *vetting*, ka deklaruar shumat e shlyera të detyrimit dhe gjendjen e këtij detyrimi të mbetur palikuiduar. Në DIPP-në e vitit 2014 nuk ka deklaruar, pasi gjatë atij viti nuk është kryer asnjë likuidim shume. Sipas subjektit të rivlerësimit, analiza e saktë për këtë vit është ajo e audituesit ligjor, e cila rezulton me balancë pozitive në shumën 3.804.609 lekë, për vitin 2013.

18.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *“Si konkluzion, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve për vitin 2013, vit gjatë të cilit është kryer edhe pagesa për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi”*.

18.2 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjekti të rivlerësimit ka deklaruar: *“Pasuria e llojit “njësi” me sip. 23,8 m², e ndodhur në Vlorë, lagja “{***}”. [...] në emër të subjektit “I. B.”, Person Fizik, e blerë në bazë të aktit noterial “Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme njësi”, legalizuar në datën 07.10.2013, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., me palë shitëse: E. M. dhe M. M. dhe palë blerëse subjektin Fizik “I. B.” PF, marrëdhënie shitblerje*

e shoqëruar dhe me aktet: “Aktmarrëveshje për likuidim detyrimi” datë 07.10.2013 dhe “Aktmarrëveshje për likuidim detyrimi”, datë 17.04.2015, legalizuar, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., nga notere A. M., Vlorë.

Çmimi i shitblerjes 9.000.000 lekë likuiduar si vijon: Shuma 4.458.280 lekë u likuidua pranë Fibank në datën 27.09.2013, shumë e cila u përdor për likuidimin e detyrimit që shitësit E. M. dhe M. M. kishin ndaj Fibank. Likuidimi vijues vazhdoi me likuidime të tjera si shpenzime rivlerësimi pranë NBG + detyrime të mbartura ndaj OShEE, sipas faturave përkatëse +500.000 lekë pranë Fibank.

- Në datën 17.04.2015 u likuidua shuma =669.536 lekë pranë BKT-së, dega Vlorë, në favor të A. M. M. sipas marrëveshjes, si dhe pjesa tjetër e detyrimit e barasvlershme në shumën 1.500.000 lekë.

- Detyrimi i vitit 2016 u likuidua si vijon: shuma =7.000 euro likuiduar në datën 08 qershor 2016, dhe shuma 3.960 euro likuiduar në datën 30.12.2016, nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare, Dega Pavarësia, Vlorë. Shumat e sipërshënuara, konvertuar me kursin e këmbimit të datës respektive janë të barasvlershme me vlerën e detyrimit të mbartur në shumën 1.500.000 lekë”.

18.3 Në DIPP-në e vitit 2013, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit deklaroi: “Njësi shërbimi me sip. 23,8 m², e ndodhur në lagjja “{***}”, Vlorë, në bazë të kontratës së shitblerjes, datë 07.10.2013, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., notere A. M., Vlorë, me palë blerëse subjekti fizik “I. B.”, me qëllim përdorimi për zyrë noterie me vlerë 9.000.000 lekë”.

Në rubrikën detyrime financiare, po në këtë deklaratë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë huaje, datë 07.10.2013, për shumën 4.200.000 lekë, legalizuar, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., nga A. M., notere Vlorë, me palë huadhënëse shoqëria “{***}” ShPK, me seli në Vlorë. [...] 2.000.000 lekë transferuar nga BKT-ja nga llogaria e kredisë, datë 12.12.2013 dhe 980.000 lekë, nga kredia pranë Raiffeisen Bank”.

18.4 Kolegji vëren se sipas kontratës²¹ së shitblerjes së datës 07.10.2013 rezultoi se personi fizik “I. B.” ka blerë pasurinë e paluajtshme “njësi”, me sipërfaqe 23,8 m², nga shitësit E. M. dhe M. M.. Në kontratë çmimi i njësisë parashikohet në shumën 9.000.000 lekë dhe mënyra e likuidimit është parashikuar në nenin 3 të kontratës, sipas të cilit shuma 4.458.281 lekë është deklaruar nga palët se është likuiduar tërësisht nga blerësi në favor të shitësit pranë Fibank, dega Vlorë, nëpërmjet llogarisë së shitësit pranë kësaj banke, në funksion të likuidimit total të detyrimit që kishte shitësi pranë Fibank, si rezultat i moslikuidimit në kohë të vlerave të kredisë²² së përfituar prej tij nga kjo bankë. Pjesa e mbetur e çmimit në shumën 4.541.719 lekë, sipas kontratës së shitblerjes, është likuiduar në formën *cash* në dorë me kërkesën e shitësit. Palët deklarojnë se rezultoi të jetë likuiduar tërësisht çmimi i shitblerjes në total 9.000.000 lekë dhe shitësi deklaroi se blerësi nuk ka më ndaj tij asnjë lloj detyrimi financiar që lidhet me likuidimin e çmimit të kësaj pasurie.

18.5 Fillimisht trupi gjykues vlerësoi nëse subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur kishin detyrimin të deklaruarin këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2013, sipas ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar. Në nenin 4 të këtij ligji, varianti i ndryshuar me ligjin nr. 85/2012 “Për disa shtesa

²¹ Kontratë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.10.2013.

²² Kontratë kredie, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.08.2010.

dhe ndryshime në ligjin nr. 9049/2003”, parashikohet: “*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri me 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si me poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to; [...]*”. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, Kolegji vëren se kjo pasuri është regjistruar në emër të personit fizik, aktivitetit të noterisë së bashkëshortes së subjektit I. B.. Gjithashtu, rezulton se në pasqyrat financiare të aktivitetit noterial për vitin 2013, në zërin “aktivet afatgjata”, është shtuar ndërtesa në vlerën 6.800.000 lekë, që do të thotë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pasqyrat financiare të personit fizik gjendjen e aktiveve të kësaj pasurie, e cila edhe në regjistrim në zyrën e pasurisë së paluajtshme figuron në emër të personit fizik “I. B.”.

18.6 Lidhur me mënyrën e pagesës së kësaj pasurie, Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton aktmarrëveshja (jo para noterit) e datës 07.10.2013, e lidhur mes palës shitëse dhe personit fizik “I. B.”, sipas së cilës rezulton se palët pranojnë se çmimi i shitjes së kësaj njësie ka qenë në shumën 9.000.000 lekë, siç është specifikuar në kontratën e shitblerjes së kësaj njësie, ku nga kjo vlerë është likuiduar nga llogaria personale e I. B., në Fibank, shuma prej 4.458.281 lekësh. Pjesa tjetër e konsideruar si e likuiduar *cash* mes palëve, sipas përmbajtjes së aktmarrëveshjes, është deklaruar si e tillë për t’i mundësuar personit fizik “I. B.” të regjistrojë këtë pasuri në emrin e tij dhe ta hipotekojë në favor të bankës për të përfituar kredi bankare, e cila do të shërbente për t’i likuiduar shitësit shumën e mbetur prej 4.541.719 lekësh. Komisioni ka konsideruar se i gjithë çmimi i njësisë është paguar në vitin 2013. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se pagesa prej 9.000.000 lekësh për blerjen e pasurisë “njësi”, me sip. 23,8 m², nuk është likuiduar në momentin e blerjes së kësaj pasurie në vitin 2013, por ka vazhduar edhe në vitet në vijim, provuar kjo me lëvizjet bankare ndërmjet palëve, si rrjedhojë, trupi gjykues, pavarësisht se konstatoi se pagesa e çmimit për blerjen e njësisë nuk është kryer e gjitha në vitin 2013, vlerëson se kjo pjesë e shkakut të ankimit nuk shihet me relevancë për arsye se kjo pasuri nuk i përket personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, por është pasuri e personit fizik “I. B.”, për qëllime të ushtrimit të aktivitetit noterial që ushtron bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezultoi se marrëdhënia juridike e shitblerjes së kësaj pasurie ka pasur si palë blerëse personin fizik “I. B.”, si dhe pagesa e çmimit të blerjes së kësaj pasurie ka pasur si burim vetëm të ardhura, të cilat personi fizik i ka siguruar me qëllim financimin e blerjes së saj. Gjatë kontrollit në Kolegji nuk u identifikua përdorimi i asnjë të ardhure të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij, si burim për krijimin e kësaj pasurie. Trupi gjykues, përveç fakteve të mësipërme, çmoi me rëndësi dhe faktin që kjo pasuri kishte gjetur pasqyrim në aktivet e personit fizik, si dhe ishte regjistruar në pronësi të këtij të fundit në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Për këto arsye, trupi gjykues nuk ia nënshtroi kontrollit në Kolegji verifikimin e ligjshmërisë së burimit të blerjes së saj. Sa i përket interesave të *overdraft*-it, që i përkasin këtij viti, trupi gjykues vlerësoi të përllogariten në të njëjtën mënyrë si në paragrafin 15.4 më sipër në këtë vendim.

18.7 Referuar sa më sipër, Kolegjit i rezultoi se çmimi i blerjes së njësisë nuk është paguar totalisht në vitin 2013, provuar kjo me lëvizjet bankare të likuidimeve të kësteve ndërmjet palëve, duke mos rënduar situatën financiare familjare të subjektit të rivlerësimit, për vitin 2013, në ndryshim nga analiza financiare e kryer në Komision, ku kjo pasuri është konsideruar

e likuiduar totalisht në vitin 2013, si dhe e krijuar me burim nga të ardhurat familjare të subjektit të rivlerësimit. Si rrjedhojë e kësaj situatë faktike, nga kontrolli i ushtruar në Kolegj analizës financiare të Komisionit, viti 2013 rezultoi me balancë financiare pozitive.

18.8 Në përfundim të sa më sipër, bazuar në situatën faktike të referuar në paragrafët më sipër, trupi gjykues konkludon se sa i përket rrethanave që përcaktojnë gjendjen faktike të këtij shkakut ankimi, personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit nuk mbart detyrimin për deklarimin e kësaj pasurie, duke qenë se është e regjistruar në emër të aktivitetit noterial, personit fizik, i deklaruar edhe në pasqyrat financiare të këtij aktiviteti, si i tillë, si dhe ai nuk gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për vitin 2013.

19. Lidhur me analizën financiare për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën e Komisionit, e cila ka rezultuar me diferencë negative në shumën (-) 731.556 lekë dhe pretendon se analiza e saktë është ajo e kryer nga audituesi ligjor, e cila ka rezultuar me balancë pozitive në shumën 210.627 lekë, duke paraqitur pretendimet si vijojnë.

i) Subjekti i rivlerësimit argumenton në ankim se Komisioni nuk ka llogaritur në analizën e financiare të ardhurat në shumën 3.100 euro, të kthyer nga vajza e tij në llogarinë e bashkëshortes, të cilat përbëjnë shumën që nuk ka shpenzuar për studimet universitare. Në analizën e Komisionit, gjithashtu, nuk është përlllogaritur si e ardhur shuma 1.000 euro e arkëtuar nga H. A., si shërbim noterial i pambyllur.

ii) Sipas subjektit të rivlerësimit në analizën e Komisionit janë përlllogaritur shpenzimet për interesat e kredisë në Raiffeisen Bank, në shumën prej 126.734 lekësh, shpenzimet për interesat e kredisë në BKT, në shumën prej 132.681 lekësh dhe pagesat e interesave të *overdraft*-it në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën prej 38.815 lekësh. Këto shpenzime janë deklaruar si shpenzime të aktivitetit noterial në organin tatimor dhe janë pasqyruar si të tilla edhe në deklaratën vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve të biznesit dhe në këtë mënyrë nga Komisioni përlllogariten dy herë.

19.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *“Si konkluzion, pas reflektimeve të bëra në analizën financiare, Komisioni konstaton se sërish vitet 2010, 2011, 2013 dhe 2014²³ paraqiten me balancë negative fondesh. Si rrjedhim, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve të tjera për këto vite, gjatë së cilave janë kryer edhe pagesa për likuidimin e kësteve për pasurinë objekt vlerësimi”*.

19.2 Kolegji vëren se nga verifikimi i kryer në gjendjen e llogarisë personale të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit I. B., në Intesa Sanpaolo Bank, në datën 21.01.2014, është transferuar për llogari të vajzës shuma 5.000 euro për studimet në Itali. Në datën 11.04.2014, po në të njëjtën llogari, është depozituar nga A. H., vajza e subjektit të rivlerësimit, shuma prej 3.100 eurosh me përshkrimin *“Trans Effect”*. Duke qenë se pas verifikimit të llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, rezulton se kjo shumë gjendet në llogari, nga Kolegji është vlerësuar që shuma prej 3.100 eurosh të përfshihet në zërin “të ardhura” në

²³ Në analizën financiare të vitit 2014, Komisionit i ka rezultuar me balancë negative në shumën (-) 731.656 lekë.

analizën financiare të vitit 2014. Edhe në raportin e audituesit ligjor, shuma prej 3.100 eurosh është përfshirë në të ardhurat e vitit 2014.

19.3 Në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në Intesa Sanpaolo Bank, në datën 13.08.2014, është depozituar *cash* në llogari nga H. A. shuma prej 1.000 eurosh. Kjo shumë nuk ka një përshkrim veprimi për të kuptuar arsyen përse është depozituar.

Nga dokumentacioni i administruar në dosje, saktësisht në pasqyrat financiare të vitit 2014, të aktivitetit privat të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, nuk gjendet e regjistruar në zërin “Detyrime/Parapagime” asnjë veprim në këtë shumë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është një veprim noterial i pambyllur (pagesë paradhënie), për të cilin nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar pretendimin e tij, duke mbetur në nivel deklarativ. Në këto kushte, duke qenë se subjekti i rivlerësimit e pretendon si të paguar për një veprim noterial të pambyllur, për të cilin nuk u evidentua destinacioni dhe përdorimi i tij, trupi gjykues çmoi se kjo shumë nuk mund të konsiderohet si e ardhur e familjes së subjektit të rivlerësimit, duke mos e përfshirë në analizën financiare të vitit 2014.

19.4 Në përfundim, lidhur me këtë shkak ankimi, Kolegji vlerësoi se nga kontrolli i kryer mbi analizën financiare të Komisionit për vitin 2014, u konsiderua i drejtë pretendimi i subjektit të rivlerësimit për t’ia konsideruar të pashpenzuar shumën prej 3.100 eurosh e hedhur në llogarinë e bashkëshortes së subjektit nga vajza e tyre. Nuk u konsiderua në zërin “të ardhura” shuma prej 1.000 eurosh e depozituar nga H. A., pasi nuk u vërtetua që ky veprim noterial është anuluar siç pretendon subjekti i rivlerësimit, ndaj, si i tillë, nuk mund të konsiderohet si e ardhur e familjes së subjektit të rivlerësimit. Lidhur me shpenzimet për interesat e kredisë, si dhe pagesat e interesave të *overdraft*-it, për të cilat subjekti pretendon se janë deklaruar si shpenzime të aktivitetit noterial në organin tatimor, u përlllogaritën si më sipër sqaruar në këtë vendim në paragrafët 15.4 dhe 18.6. Duke pasqyruar sa më sipër, në analizën financiare të Komisionit për vitin 2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme, për të përballuar kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive për diferencën negative në shumën (-) 297,317 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

20. Lidhur me automjetin tip “DaimlerChrysler”, me targë {*}, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se ai nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *vetting* është i gabuar. Subjekti i rivlerësimit argumenton se nga verifikimi i kryer me personelin e teknologjisë së informacionit në kompjuterin e punës, ku subjekti i rivlerësimit ka pasur të ruajtur deklaratën e pasurisë për vitin 2015, e cila është dorëzuar në vitin 2016, rezulton të jetë e deklaruar prej tij kontrata e shitblerjes së këtij mjete në seksionin përkatës së kësaj deklarate. Sipas subjektit të rivlerësimit, mungesa e këtij deklarimi në DIPP-në vjetore të dërguar nga ILDKPKI-ja duhet të ketë qenë problem printimi. Në lidhje me mosdeklarimin e këtij mjete në deklaratën *vetting*, subjekti shpjegon se në mënyrë të pasaktë këtë pasuri e ka deklaruar në seksionin “Përshkrimi i të ardhurave”, të kësaj deklarate.**

20.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: “[...] konstatohet se: (i) në deklaratën *vetting*, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj; dhe (ii) subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-të vjetore të depozituara në ILDKPKI”.

20.2 Në deklaratën *vetting*, në rubrikën e të ardhurave, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Autoveturë Daimler Chrysler S320 CDI, targa {***}, viti prodhimit 2003, çmimi i shitblerjes 500.000 (pesëqind mijë) lekë, e përfituar në bazë të kontratë shitblerje – autoveturë, legalizuar në datën 23.02.2015, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., nga notere A. M., Vlorë*”.

Në DIPP-në e vitit 2015, që gjendet e administruar në dosjen e ILDKPKI-së, nuk gjendet e deklaruar blerja e automjetit në asnjë nga rubrikat e kësaj deklarate periodike vjetore.

20.3 Kolegji vëren se nga dokumentacioni që ka bashkëngjitur DPShTRr-ja, në kthim përgjigjen²⁴ dërguar Komisionit, rezulton kontrata²⁵ e shitblerjes së mjetit “Mercedes-Benz” i tipit “DaimlerChrysler”, në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Referuar kontratës së shitblerjes së mjetit, palët kanë deklaruar se likuidimin e çmimit të kësaj pasurie në shumën prej 5.000 eurosh e kanë realizuar ndërmjet tyre jashtë zyrës noteriale, në formën e paradhënies.

20.4 Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, ka pyetur subjektin në lidhje me periudhën (kohën) dhe mënyrën (*cash* apo me bankë) e likuidimit të çmimit për blerjen e kësaj pasurie, në përgjigje të së cilës subjekti i rivlerësimit, sqaroi se [...] *Shitësi i mjetit, A. Ç., është bashkëshorti i shtetases J. Ç. (B.), e cila është motra e bashkëshortes. Në kontratë është deklaruar se çmimi i shitblerjes është likuiduar tërësisht në formën cash, jashtë zyrës noteriale. Për arsye të marrëdhënies së posaçme që kam pasur me shitësin, mjetin e kam marrë në përdorim para lidhjes së kontratës, rreth muajit tetor të vitit 2014 dhe likuidimin e çmimit e kam realizuar cash me dy këste, nga të cilat 250.000 lekë në fund të vitit 2014 dhe 250.000 lekë në datën e lidhjes së kontratës, shkurt 2015. Ndërsa, si burim të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, kanë qenë paga ime dhe të ardhurat nga aktiviteti i noterisë i bashkëshortes sime.*

Gjithashtu, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të dërguar në Komision, subjekti i rivlerësimit sqaron se në kompjuterin e tij të punës deklarata e pasurisë për vitin 2015 është e ruajtur me të dhënat sikur e ka deklaruar krijimin e pasurisë automjet “DaimlerChrysler”, por mospasqyrimi i këtij deklarimi mund të lidhet me probleme të ndryshme teknike që mund të kenë ndodhur nga printimi.

20.5 Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, ka dorëzuar në Komision *print screen* (foto e printuar nga ekrani) me detaje të dokumentit, që subjekti i rivlerësimit pretendon se është deklarata periodike e pasurisë për vitin 2015, plotësuar në kompjuterin e tij. Sipas të dhënave në *print screen*, dokumenti (deklarata e vitit 2015) është krijuar në datën 17.03.2016. Nga verifikimi i deklaratës periodike të vitit 2015, të administruar në ILDKPKI, rezulton se këtë deklaratë subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar më 17.03.2016, datë e cila është e njëjtë me atë të treguar në *print screen*. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur në Komision edhe printim të faqes nr. 3 të deklaratës periodike të vitit 2015, të cilën pretendon se e kishte të ruajtur në kompjuterin e punës. Në këtë deklaratë rezulton e pasqyruar pasuria si vijon: “*Automjet DaimlerChrysler S320 CDI, targa {***}, viti Prodimit 2003, e përfituar në bazë të kontratë shitblerje – autoveturë, legalizuar në datën 23.02.2015, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., nga notere A. M., Vlorë, çmimi i shitblerjes 500.000 lekë, pjesa takuese 100%*”.

²⁴ *Shkresë e DPShTRr-së nr. {***} prot., datë 07.02.2019.*

²⁵ *Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.02.2015.*

20.6 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* burimin e krijimit të kësaj pasurie. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pika 7 e Udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklaramit të pasurisë për procesin e rivlerësimit detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur, të burimit në momentin e krijimit të saj, ku me burim nënkuptohet origjina e mjeteve financiare që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë. Në këto rrethana faktike të mosdeklarimit të burimit të krijimit të pasurisë automjet “DaimlerChrysler” në deklaratën *vetting*, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, paragrafët 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, shkelje e cila kualifikohet në përcaktimet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84.2016.

20.7 Kolegji vëren se pasurinë automjet “DaimlerChrysler” subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ndërsa në deklaratën *vetting* e ka deklaruar në rubrikën “të ardhura”. Sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për të deklaruar pasurinë e luajtshme automjet, e pasqyruar kjo edhe në formularin e deklarimit të pasurisë. Pavarësisht pretendimit të subjektit se e ka deklaruar automjetin në deklaratën periodike të vitit 2015, por ka qenë një problem teknik që nuk ka mundësuar pasqyrimin, në dosjen e ILDKPKI-së rezulton se nuk është deklaruar. Gjithsesi, ky automjet është blerë me kontratë shitblerje të nënshkruar para noterit, si dhe i regjistruar në regjistrat publikë si ai i DPSHTRr-së për sa kohë kjo e fundit ka dërguar dosjen e mjetit në Komision. Si rrjedhojë e kësaj situate, faktin që blerja e automjetit rezulton e padeklaruar në deklaratën periodike të vitit 2015, trupi gjykues e konsideroi se përbën një pasaktësi, e cila nuk është e një niveli të tillë, që të të shërbejë për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

21. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nga Komisioni, parashtrimet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se gjendet i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; dhe (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
22. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Enrik Haxhiraj gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 339, datë 19.01.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 339, datë 19.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Enrik Haxhiraj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 05.07.2023.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi